

ZIJA ÇELA  
**LAVJERRËSI I QYTETIT**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



ZIJA ÇELA

LAVJERRËSI  
I QYTETIT

**roman**

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Përkujdesje grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

Imazhi në kopertinë: Saimir Strati

ISBN 978-9928-277-59-6

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## **Lavjerrësi dhe Autori**

“Lavjerrësi i Qytetit” sjell një dramë me konotacion universal, e krijuar nga ligësitë dhe vanitetet njerëzore, kur e mira dhe e keqja ndërrojnë vendet, kur vesi ia zë vendin virtytit, kur e pandershmja ngrihet mbi të ndershmen, në një shoqëri ku vlerat morale këmbehen me pasionet e ulëta, duke humbur çdo masë për të identifikuar të drejtën dhe të vërtetën.

Romani është një metaforë, që funksionon në të gjitha kohët, në të tashmen dhe në të ardhmen, një metaforë e frikshme me absurdin e saj, por domethënëse me porosinë e gjithëbotshme.

Zija Çela nuk resht të na sëmbojë me depërtime të mprehta kritike. Por edhe të na i shërojë plagët me vëzhgimet e holla brenda shkarjeve tona të marrëzishme, duke vazhduar të na nxjerrë të gjithëve në projeksione imagjinare të pashembullta. Duke na gjykuar ashpër, por edhe duke na përqeshur njëkohësisht. Duke na marrë me të mirë hera-herës, por edhe duke na fshikulluar pamëshirshëm. Duke krijuar situata dhe personazhe, që mbahen mend për çmendurinë dhe kotësinë e ekzistencës së tyre, si

antiheronj të paparë të një kohe dhe të bëmave të saj pa lavdi.

Në romanin e ri të Çelës, në një vend imagjinar, ndodhin gjëra vërtet të çuditshme, por aq të nxitura nga marrëzitë tona kolektive dhe individuale, sa të na duket krejt e mundshme që një mëngjes të bukur të zgjohemi pikërisht në një habitat të tillë: një qytet-burg, ku nuk kuptohet më kush është i lirë dhe kush është i burgosur, kush është i ndershëm e kush i pandershëm, kush është i dënuar dhe kush gjykatës, kush është viktimë dhe kush është kriminel. Në këtë pikë, në ndërtimin e një realiteti imagjinar dhe metaforik, Zija Çela i ngjan një Oruelli të letërsisë shqipe.

Edhe te “Lavjerrësi” spikat gjithnjë identiteti i veçantë shkrimor, që autori e ka krijuar me kohë, proza e tij me frazë të gdhendur hijshëm, me leksik funksional, shpesh me kuptime të bartura dhe depërtime të thella në botën e ndjesisë e të mendimit. Në këtë proces krijues elegant e sqimatar, siç bëhet përçmues ndaj vogëlsisë njerëzore, ai shfaq papajtueshmëri ndaj të rëndomtës letrare dhe përdorimit “pa dinjitet” të atributëve artistike të fjalës së shkruar. Por njëkohësisht, po aq sa ç’është kërkues, Zija Çela është edhe demonstrues i një standardi gjuhësor të arrirë në të tëra mundësitë shprehëse, mbi të gjitha, duke krijuar një model shkrimi që bashkëkohëson dhe modernizon letërsinë shqipe në të gjithë përbërësit e saj.

Siç jam shprehur tashmë, Zija Çela është shkrimtar që materializon në letërsi ndryshimet substanciale në botën shqiptare. Ai identifikohet si shkrimtar përfaqësues i letërsisë shqipe në kohën kur, në mileun shqiptar, ndodhin ristrukturime dhe përmbysje të mëdha. Ndryshe nga shumë autorë të asaj periudhe, të cilët nuk arrijnë t'i kapin këto rrjedha, me Zija Çelën do të ndodhë një fenomen tjetër: ai do të jetë në krye të shkrimtarëve shqiptarë që, në pikëpamje letrare, nuk e traumatizon rënia e një sistemi vlerash dhe ngritja e një sistemi të ri vlerash. Në fund të viteve tetëdhjetë dhe në fillim të viteve nëntëdhjetë, Zija Çela e ka shpallur tashmë programin e tij letrar. Ai do të realizojë ciklin e parë të romaneve të rëndësishme, “Gjaku i dallëndyshes”, “Gjysma e Xhokondës” dhe “Banketi i hijeve”, me të cilat do të bëhet model i frymës së re në prozën shqipe. Ndërsa tetë romanet e tij të fundit, të marra së bashku, përbëjnë sagën alegorike më të madhe të letërsisë shqipe.

Lexuesi shqiptar, i cili sot lexon Markesin, Sabaton, Kunderën, Grasin, njësoj si Xhojsin, Prustin, Kafkën, Kamynë, Kalvinon e Buzatin, mund ta lexojë më me ëndje edhe Zija Çelën sepse, nga njëra anë, ai sublimon arritjet e mëdha të prozës së shekullit XX në ndërtimin e fakturës tekstore dhe të prosedeut, ndërsa nga ana tjetër, me tematikën e veprave të tij u bën jehonë pësimeve dhe dilemave të shoqërisë njerëzore.

Mehmet KRAJA





# 1

Megjithëse arrita ende pa ia mësyer turma, e cila kishte marrë përsipër të mbështeste kërkesat e të burgosurve, asnjë nga gazetarët nuk mundi ta kalonte kordonin policor. Në vendin e ngjarjes u ndaluan në fund të shëtitores, në vijën veriore të rrugës që ndante qytetin nga korpusi i burgjeve 717/3. Sipas një vendimi të këshillit bashkiak, prej shumë vitesh aty ishte vendosur një kufi i prerë. Dy krahët e së njëjtës rrugë kishin emërtime të ndryshme. Krahu nga qyteti quhej Rruga Të Ndershmit, ndërsa krahu i burgut Rruga Të Pandershmit. Mirëpo në të katër korsitë e saj, sado bënte pjesë në unazën e Burgasit, ishte ndaluar qarkullimi, pasi turbullirat e të burgosurve pritej të përshkallëzoheshin.

Po bëhej java që raportoja për gazetën sa nga terreni, sa duke mbledhur info nga burimet e mia. Thuhej se fillimi i trazirave kishte qenë paksa i çuditshëm. Në orët e ajrimit, teksa bënë rrethrotullimin në oborr, papandehur burrat kishin lëshuar ca vikama, që u ngjanin gjallesave johumane. Dhe kur përgjegjësi i Sigurisë pyeti përse po angullinin, hingëllinin, lehnin,

buluronin e pallnin ashtu, si të ishte i autorizuar për përgjigjen, vetëm Emanuel Karabolli kishte folur:

- Sepse ju po na trajtoni si kafshë.

Ndërkaq, me të dëgjuar vikamat e meshkujve, nga oborri i burgut të tyre gratë u qenë përgjigjur me ca britma të thekshme, thua se po e vajtonin tani atë nusen e re, që muaj më parë i kishte dhënë fund jetës në qelinë 5. Madje, me gjithë ofshamat pikëlluese, më gjuhustrat nuk mjaftoheshin me kaq. Duke ndukur faqet, ato u jepnin edhe munxët rojave të kullave. Por nuk mbetën prapa as adoleshentët e burgosur. Tifozerinë ndaj burrave e grave e kishin shfaqur me gjuhën e kuptueshme të stadiumit, oleve të forta e ritmike.

Antonella Boeti, një italiane e shoqërisë civile (ajo kishte zbarkuar me të parët në Burgas), më pyeti nëse për turbullirat ishte bërë shkak ëndrra, për të cilën kishte dëgjuar të flitej në hotel. Si mundet që një ëndërr të bëhet shkak, iu gjegja, ëndrra mund të ketë qenë vetëm parandjenjë.

Një burim i brendshëm më kishte pohuar se në arkivin e burgut gjendeshin tri-katër arka me materiale letre, të sekuestruara gjatë viteve. Gjithmonë ishte shfaqur ndonjë besëtytë që kishte regjistruar ëndrra nga vagullitë e bashkëvuajtësve. Disa kishin mbetur anonimë, por disa me emra, si skribti që kishte regjistruar ëndrrën e fundit.

Thuhej se, një natë, të burgosurit Sinan Maca iu faneps sikur ishin hapur tej e tej portat përballë

shëtitores. Ajo e madhja me dy kanata, ku kalonin automjetet, si dhe dera e vogël ndanë portinerisë së oficerit të rojës, nga kalonin vetëm këmbësorët. Çudia ishte se para të dyjave kishte karvanë njerëzish. Nga brenda, në oborr, ishin rreshtuar të burgosurit. Nga jashtë, në rrugë, qytetarë të lirë. Të dënuarit ishin vënë në njëshkolonë, qytetarët në rreshtim me radhë të gjera. Me të filluar lëvizja, u pa se po ecnin në kahje të kundërta, qytetarët nga jashtë brenda, të burgosurit nga brenda jashtë. Mirëpo ndërsa të parët hynin lehtësisht me nga një duzinë njëherësh, njëshkolona e të dënuarve ecte shumë avash, si të përshkohej në vrimë gjilpëre, duke dalë një nga një. Mbartësi i ëndrrës ndodhej diku nga fundi dhe, herë pas here, ngrihej në majë të gishtave për të kapur me sy largësinë nga kreu. Ndërkaq, ca nga trysnia e pritjes dhe ca nga lëvizja e zvargur, po ndiente shtrëngime poshtë barkut. Kur iu ankua atij që kishte përpara, Vesel T. i kujtoi se kafshët defekojnë (dhjesin - Ditari i Fabianit) më këmbë. Ndërsa kur iu ankua atij që kishte mbrapa, Napoleoni hoqi kapelën tricepëshe dhe iu hakërrye: “Qelbanik, dil nga rreshti!” Mirëpo ta braktisje rreshtin, do të thoshte që të ktheheshe me këmbët e tua aty ku kishe qenë, në kaushin e burgut.

Sipas regjistruarit, ky nuk e dinte sa kishte zgjatur makthi. Por kur i doli gjumi, ankthi nuk po i shqitej. Derisa iu kujtua fjala e urtë, që sikur i jepte një kuptim fanepsjes: “Dera e burgut është e madhe për të hyrë, por e vogël për të dalë.”

## 2

Ç'është e vërteta, edhe ne andej po i mbanim sytë, siç mbaheshin gjithashtu kamerat e kanaleve televizive. Por në krahun Rruga Të Pandershmit asnjëra portë nuk po hapej. Ne prisnim të dilte dikush dhe të deklaronte diçka për gjendjen në 717/3. Në mos vetë Todi Ristani, drejtori i IEVP-së (Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale), të paktën zëvendësi i tij, specialisti i informacionit, përgjegjësi i ruajtjes së sigurisë apo ai i shërbimit shëndetësor. Në mëngjes i kisha kërkuar një intervistë drejtorit. Por Todi Ristani më kishte kujtuar Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, nenin 49, paragrafin 4, si moskompetencë e tij për hyrjen e mediave në regjimin e brendshëm të institucionit. Teksa më shkruante këtë mesazh, e përfytyroja si shkrihej nga kënaqësia, duke rrudhosur paksa fytyrën verdhane. E ka surratin si të përmjaltur, thua se Zoti s'e ka bërë për tjetër, veçse për të mbledhur miza rreth vetes, shpreheshin të burgosurit, qëkurse drejtori kishte kërkuar përforcime në korpus përkundrejt trazirave. Mirëpo, tashmë, zoti Ristani më kot mendohej t'i vinte perde acarimit të gjendjes.

Prej gjashtë ditësh shtatëmbëdhjetë burra dhe nëntë gra kishin nisur një grevë urie. Por edhe pesë adoleshentë po e refuzonin ndërkohë ushqimin e drekës dhe të darkës. Alarmi ishte përcjellë në kryeqytet menjëherë. Prej atje, të djeshmen, kishin mbërritur në Burgas këshilltari i Ministrit të Brendshëm, disa forca speciale të policisë, si dhe një ekip i kompletuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Të ballafaquar me grevistët, ata mësuan se kërkesa e tyre kryesore lidhej me kushtet e këqija të vuajtjes së dënimit. Aq mbipopullim kishte në atë korpus, sa mungonin edhe krevatet e shtresat. E në këto rrethana, personeli mbante vazhdimisht të burgosur në të gjitha qelitë, jo për ndëshkim, por për mungesë vendesh në kapanone. Ata e bënë me rotacion, kush kishte fjetur në shtrat, kalonte në qeli dhe atyre që ishin gdhirë pa jatak nëpër qeli, u jepej natën shtrati.

Ekipi kryeqytetas kërkonte ta ndalonte grevën me argumentin se ishte e paligjshme. Ju keni shkelur dispozitat, ngulmonin. Përpara se ta nisnin grevën e urisë, pjesëmarrësit duhej të nënshkruanin një deklaratë, ku merrnin mbi vete të gjitha pasojat që mund të rridhnin nga mosushqyerja. Mirëpo edhe të burgosurit, të këshilluar nga avokati i Emanuel Karabollit, ia kishin gjetur rrëfanën këtij ngërçi. Ata thoshin, ne e kemi nënshkruar deklaratën kur bëmë grevë urie vitin e shkuar, kjo nuk është e re, është vazhdimi. Dhe kështu, vetvetiu, lihej të kuptohej se autoritetet asnjëherë s'ua kishin vënë veshin.

Në shkrimet e mia kisha raportuar edhe takimin e një grupi ambasadorësh, përfshirë amerikanin, me një përfaqësi të burgosurish. Meqë 717/3 nuk është burg i sigurisë së lartë, po përdoret si të jetë hambar, u qe ankuar Fabian Rudi Hoketa. Dhe kur ata i kishin kërkuar argumente, Fabiani kishte shtuar: Thuajse çdo ditë shihen furgonë policie duke sjellë të dënuar të rinj, që përfundojnë rras e plas në fjetoret tona. Me gjasë, edhe burgjet e tjera janë plot, prandaj na kthehen mbrapsht lutjet për t'u transferuar më afër vendbanimit të familjes.

- Ah, zotërinj të nderuar, sa ju kemi pritur kësaj here për Thanksgiving... Por na munguat në Mëngjesin e Lutjeve.

Pikërisht pas kësaj psherëtime, e cila ndoshta shprehte dobësi, kishte ndërhyrë Emanuel Karabolli. Ai kishte rrëfyer se familjarët e një të burgosuri kishin ofruar dhjetë mijë euro për transferimin e njeriut të tyre. Mirëpo, ngaqë garanti kishte kërkuar pesëmbëdhjetë mijë, pazari ishte prishur. Ajo familje, pohonte i bindur Karabolli, ishte në gjendje të paguante edhe tridhjetë mijë. Por u zmbrops prej vullnetit kokëfortë të vetë të burgosurit. Dhe krejt nga inati. Ai e dinte se disa transferime bëheshin duke dhënë nën dorë vetëm tri mijë euro, zotërinj.

Në një konferencë për shtyp, me anë të zëdhënësit të saj, Ministria e Drejtësisë u mundua t'i amortizonte disi pasojat e këtij takimi. Por ekzistonte frika se ndërkombëtarizimi i çështjes mund të vinte në lëvizje

Këshillin e Europës, madje deri edhe Këshillin e të Drejtave të Njeriut pranë OKB-së. Metoda e nëndheshme që organizmave të huaja t'u kufizohej përkohësisht inspektimi në burgje, nuk gjeti miratimin e Kryeministrit, i cili i kishte mjaft telashet me Komitetin e Helsinkit. Sidoqoftë, pa ndonjë udhëzim të shkruar, nëpunësit e ministrisë prapëseprapë do t'i zvarrisnin afatet e shqyrtimit të kërkesave nga jashtë. Madje hapën fjalë se, për arsye restaurimi, ai burg do të mbyllej përkohësisht.

Këto manovra zyrash po sillja ndër mend, teksa një valë oshtimash nisi të m'i zuzullonte veshët.

### 3

Kishte ardhur çasti kur, për afërsisht në orën që kishte qarkulluar në Internet, të gjithë kthyem kokën në të kundërtën. Një turmë vërshuese qytetarësh po dyndej përmes shëtitorës drejt korpusit. Gjëma e saj, s' di pse, më kujtoi thyerjen e digave. Por vërshimi ndaloi pa na marrë përpara, sado që shkaktoi dallgëzime të incertisë. Megjithatë dita kishte diell të penguar, pamja ishte përgjithësisht e mirë.

- Pa shih sa shpejt e përforcuan softuerin, - nënqeshi kolegu pranë meje, duke aluduar për kordonin policor, sistemin e tyre operativ.

Tashmë kordoni ishte trefishuar dhe në radhën e parë dolën forcat speciale me kasa, mburoja e shkopinj gome. Por protestuesit po i qëndronin besnikë strategjisë së tyre: vetëm trysni verbale e vizive. Të thirrur nga shoqëria civile, duke marrë në mbrojtje ankesat e të burgosurve, qytetarët e Burgasit nuk protestonin të hallakatur, por të përbashkuar në thirrjet: “Stop shkeljes së të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut! Respekt ndaj Kushtetutës!” Ishte një binom që institucioneve u fuste drithmat, sepse prekte palcën e demokracisë.



Nuk m'u desh shumë të kuptoja se shoqëria civile e kishte kuruar protestën, duke ndjekur parime të thjeshta aritmetike. Për kundërshtarët e tyre kjo gjuhë ishte menjëherë e kuptueshme. E po ashtu për të gjithë ata që kishin informacion. Gjuha e numrave mund të krijonte ndonjë paqartësi vetëm për të huajt, që ende s'kishin hollësi nga korpusi. Tri pankarta binin në sy më tepër. Italiania Antonela Boeti, duke lypur ndjesë, m'u afrua sërish dhe kërkoi shpjegime për secilën. I thashë se dy të parat, ku shkruhej  $9\text{ m}^3 - 4.5\text{ m}^3 = 4.5\text{ m}^3$  dhe  $4\text{ m}^2 - 2\text{ m}^2 = 2\text{ m}^2$ , i referoheshin Rregullores së Përgjithshme dhe theksonin përgjysmimin e kushteve të banimit në korpus. Sipas rregullores, çdo të burgosuri duhej t'i sigurohej një kubaturë të paktën prej nëntë metrash dhe një sipërfaqe jo më pak se katër metra katrorë. Pankarta e tretë, me veprimin zbritës  $12 - 6 = 6$ , nënkuptonte shpenzimet që bënte qeveria për kokë. Të burgosurit po ankoheshin se pretendimi për 12 ishte i gënjeshtërt, kostoja ditore për çdo të burgosur ishte katandisur në 6 euro. Pasi tha se gjashta është numri i Djallit, ajo shtoi se nëse rekordin e mbante San Marino me 750, e ndjekur nga Suedia me 631, mesatarja e gjithë Europës ishte 51.9 euro.

- Pankarta me figurën e kundragazit kuptohet vetiu, - thashë.

- Po, po, - nxitoi Antonela. - E mora me mend, fjetoret nuk kanë oksigjen të mjaftueshëm.

- Por edhe ajrimi në mjedise të hapura është përgjysmuar. Nga dy orë, për arsye sigurie, ua kanë

bërë një. Ndërsa prej tri ditësh, me ndonjë përjashtim, i mbajnë të mbyllur. As marrëdhënie pune, as ajrosje, as aktivitete të tjera.

Ajo pikasi dikë aty pranë dhe nisi të mënjanohej, ndërsa mua më ndihu fati për telefonatën që prisja. Ç' bëhej këto çaste pas dyerve të korpusit? Burimi im i brendshëm as i dinte të gjitha, as mund të depërtonte kudo. Ai tha se, sipas rregullave të sanksionuara, konsiderohet sjellje shumë e rëndë organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e veprimtarive që cenojnë masat e sigurisë në institutet penitenciare. E ndoshta kjo po ndodhte. Por, po ashtu, përbën shkelje të rëndë kundërshtimi me dhunë ndaj punonjësve të IEVP-së. E kjo nuk po ndodhte.

- Çfarë po ndodh ahëre? - iu drejtova i paduruar.

Ai përdori fjalën *blindim*. Ndërtesa e administratës është blinduar, tha, s'di kush ndodhet në zyrën e drejtorit dhe çfarë diskutohet atje. Në burgun e burrave kanë bërë një lëshim. Kanë zgjedhur ca të moshuar për ajrosje. I shoh tek vijnë mullarthe nëpër oborr. Ecin ngadalë, kokulur e pa lëvizur as krahët, në mënyrë që uniformat të mos ua marrin lëvizjet për gjeste provokimi. E di si po më ngjajnë? Si kuaj të telendisur, që presin radhën në thertoren e sallamit... Lëri përshkrimet, e ndërpreva, dua fakte. Ç'janë ata zërat e mbytur, nga vijnë? Vijnë tutje nga sektori i adoleshentëve. Dhe bëjnë Ole? - pyeta. Jo, ata po thërrasin: "Policia është me ne, është me ne!" Të më falësh, por më duhet ta mbyll telefonatën tani. Shoh lëvizje të forcave drejt...

Ndoshta drejt burgut të grave, mendova. Sepse pikërisht prej andej po ngjitej një tym i zi, si të buftonte prej ndonjë kazani ku digjej serë. Gratë i kishin vënë flakën një kapice me nënkresa, shapka e çizme llastiku, duke rrezikuar që zjarri të përhapej, nëse nuk shuhej shpejt. Mund të hamendësohej se sektori i tyre ose nuk kishte mundur të bashkërendohej me dy të tjerët, ose po dëshmonte mosbindje. Byroja e Kastave, një term që kohët e fundit qarkullonte ilegalisht mes të dënuarve, përbëhej nga përfaqësuesit e disa klaneve. Sado kundërthënëse, bashkërendimin për këtë lëvizje e kishin marrë përsipër Asnjanësit, një grupim që udhëhiqej nga Emanuel Karabolli. Për të mos lënë prova të filmuara gjatë organizimit të fshehtë, Karabolli nuk i kishte takuar personalisht krerët e tjerë. Por udhëzime kishte dhënë. Ata ishin shpërndarë nëpërmjet spaçatorëve të drogës, të përshtatur në burg për të bërë korrierin diplomatik. Udhëzimet thoshin, nga të gjithë kërkohet bindje dhe disiplinë e përbashkët. Vetëm vizorja i ndan turbullirat nga rebelimi. Nëse lëvizja jonë klasifikohet rebelim, ahëre shpallet Gjendja e Jashtëzakonshme dhe të gjitha masat shtrënguese bien mbi kurrizin tonë. Duke qenë në shi, pse dreqin të shkojmë në breshër?!

Të burgosurit, ashtu si opinionioni publik, ende nuk e dinin se ç'ndryshime të papritura do të merrte situata për së shpejti. Sidoqoftë, ajo kolona e tymit që krijoi kërpudhë përpjetë, e rrëqethi turmën. Kësaj here dallgëzimet përpara qenë të vetëdijshme dhe kordoni

politor u detyrua të zbrapset, por vetëm pak hapa. Një lajm i dyshimtë u përhap me shpejtësi. U tha se në brendësi të korpusit, përveç gazit lotsjellës si kamuflazh, po përdorej edhe gaz helmues luftarak. Kryetarët e shoqatave mezi arritën t'i përmbanin qytetarët e tronditur, duke u bërë thirrje që të mos binin prë e një *faik news*. Dhe shumica e tyre u përgjigjën me brohoritma, me trumbeta e bubuzhela. Zhurmëhuria e zallahia e shkundi nga tabani shëtitoren e Burgasit. Por shkundulloi edhe hapësirën e burgjeve.

Si nja dhjetë minuta më vonë, kur zjarri tashmë ishte shuar dhe brohoritmat po reshtnin, pamë të hapej dera e vogël. Të parë nga Todi Ristani, i cili mbante megafon në dorë, dolën prej andej edhe katër të tjerë. Të gjithë civilë. Të katër i përkisnin ekipit kryeqytetas që, veç të tjerave, kishte synuar ta ndërpriste grevën e urisë. Drejtori Ristani kërkoi mirëkuptim për dëgjuesën. Por kur u pandeh se do të mbante ndonjë fjalë, ai ia kaloi megafonin një mesoburri me trup të bëshëm, që suita e kishte vënë në mes. Ishte Zihni Aviduli, dora vetë, këshilltari i Ministrit të Brendshëm.

Nuk dihej përse, pasi kishte dalë në lirim nga ushtria me gradën e kolonelit, ministri e kishte përfshirë menjëherë në stafin e tij. Ai binte në sy për mbiballin e zhveshur deri në polin e kokës dhe ato buzët e rënda, të nxjerra përpara, thua se gjithë kohën në ushtri e kishte kaluar duke i fryrë bilbilin. Me të mbërritur në Burgas, çka ishte konfirmuar tashmë, zoti Aviduli i kishte kërkuar drejtorit që t'u bëhej të

dënuarve gjashtë orë stërvitje rreshtore. Por droja se do të ndeshnin në mosbindjen e tyre, e detyroi të ndryshonte taktikë. Më mirë një gjendje amullie, sesa një gjendje rebelimi, shestoi me vete. Në ato çaste nuk kishte si t'i shkonte mendja se, në rangjet e larta të qeverisë, situata tashmë po arsyetohej ndryshe.

Njëloj si për drejtorin Ristani pandeha se, për ta qetësuar zemërimin e turmës, këshilltari Aviduli do të mbante ndonjë fjalë. Por ai u tregua edhe më i prerë. Me ta ngritur megafonin, a thua se turmën e kishte nën komandë, foli si të jepte urdhër.

- Kam vetëm një njoftim për ju dhe shpërndahuni pastaj menjëherë! Nesër vjen në Burgas vetë Ministri i Brendshëm. Udhëzimet përkatëse do t'i jepen pushtetit lokal.

Në çastin kur media hodhi pyetje për natyrën e vizitës së ministrit, ata na kthyen shpinën dhe dera e vogël u mbyll pas tyre, sepse oficeri i rojës i kishte pritur më këmbë.

Kush mund të dinte më tepër për këto udhëzime, që gjithsesi m'u dukën disi misterioze? Atë mbulesën, që krijonte koha e ardhshme me “do t'i jepen”, e ktheva në të kryerën, udhëzime që tashmë i qenë dhënë pushtetit vendor. Hëpërhë e përjashtova kryetarin e bashkisë që, duke mos dashur t'u kundërvihet zgjedhësve të vet, s'po bëhej gjëkund i gjallë. Personi më i mundshëm që dinte diçka, mbetej zyrtari i qeverisë, prefekti i qarkut.

Nxora makinën nga qoshku ku kisha parkuar dhe, sapo lashë rrugën dytësore, mora drejt qendrës. A do të mund t'ia rrëmbeja Sazan Manzuranit një intervistë, qoftë dhe me pak fjalë? Gjysmën e raportit për gazetën e kisha shkruar në orët e drekës. Shënimet e tjera i kisha gati dhe, me t'u ulur para laptopit, do ta përfundoja në kohën e duhur. Isha porositur se titulli i madh (patjetër me boks) do të hapte gazetën e së nesërme, prandaj do ta strukturoja edhe me nëntituj për vijimin. Në krahasim me kolegë të tjerë, unë kisha epërsi në burime. Deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç kisha jetuar në Burgas, pastaj ishim shpërngulur

familjarisht në kryeqytet. (Ndjesë paçin, prindërit s’e patën të gjatë!) Mjaft nga shokët e atëhershëm tani i gjeja në pika kyçe të administratës apo shoqërisë civile. Ata më ushqenin me info. Por, kësaj here, në shkrimin tim do të përfshija edhe dy ekskluzive.

Cilat ishin?

Drejtori i madh, ai i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e kishte për detyrë që të dënuarit me aftësi të kufizuar të mos u nënshtroheshin eksperimentimeve mjekësore a shkencore, pa pëlqimin e tyre të lirë. Megjithatë, rreth tetë muaj më parë, nënshtrimi kishte ndodhur. Të burgosurve u ishte thënë: “A doni të shkoni për diagnostikim në Perëndim?” “Duam, si nuk duam!”, ishin entuziazmuar ata. Por në letra mungonte argumenti *diagnostikim*, aty shënohej vetëm se po dërgoheshin me dëshirën e tyre dhe me shpenzimet e palës pritëse. Si zor të besohej se, në këtë allishverish, motivi ishte për të hapur ca vend në hambarin e mbushur përplot. Lepuri flinte diku më thellë.

Ekskluzivja e dytë ishte një video me karvanin e gjatë të të burgosurve, që prisnin radhën për në WC. Fotot prej saj kryeredaktori le t’i zgjidhte vetë. Aty shiheshin të dënuar që, nga pamundësia për ta mbajtur urinën, kishin përmjerrë në shishe plastike me qafa të prera. Mirëpo edhe për t’i derdhur shisheet në sifon, këta duhej të respektonin radhën, sepse ndryshe mund të kacafyteshin me nevojtarët e tjerë. Unë kisha rrëfyer në tekst edhe një vrojtim nga shërbimi i kontrollit të

pakove, që hynin në IEVP. Në bazë të kërkesave të të burgosurve, familjarët u dërgonin shpesh detergjentë pastrues dhe dezinfektues, sigurimi i të cilave ligjërisht i takonte korpusit.

Teksa përshkoja rrugën dytësore, vetiu më ndërmendeshin kujtimet e gjimnazistit. Tjetër shihja, tjetër kujtoja. Unë kisha në kokë një urbanistikë dhe arkitekturë të dyzuar, për shkak të ndryshimeve që kishin ndodhur. Ndërsa, dikur, tërë kjo fushëgropë mes maleve kishte qenë e zbrazët. Në vitin 1901-1903 turqit ndërtuan aty një burg. Kazerma, magazinat dhe banesat e para u ngritën për efektivat. Pastaj u shtuan shpejt familjarët, që kërkonin tokë të lirë. Meqë vendbanimi u krijua prej burgut, nën ndikimin e turqishtes qarkullonin njëherësh disa emërtime: Burgalet, Burghaxhet, Burgibret, etj. Thonë se toponimi që ndodhej diku larg, emërvendi Burgajet, fshati ku do të lindte mbreti i parë shqiptar, sado i ngjashëm nga rrënja e fjalës, nuk kishte ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me turqizmat alet, haxhet apo ibret. Sundimtarët, të cilët u ndërruan nëpër kohë, burg e gjetën dhe burg e lanë. Por vetë vendbanimi, në regjistrat e vitit 1951, ekzistonte me emrin *komuna e Burgasit*.

Teksa i afrohesha vinotekës Proseco, pashë tek ecte në trotuar prokurorin Nevil Zusi, i cili jo vetëm në kaushet e korpusit, por edhe në mjediset e drejtësisë penale njihej me nofkën Zeusi. Jashtë zyrës, atë s'e shihje kurrë pa çantën me dorezë të zezë. Duke e



ngadalësuar makinën, ula xhamin në krahun tim dhe i dhashë një përshëndetje të zëshme. Mora fluturimthi prej tij vështrimin e hekurt dhe atë buzëqeshjen e sforcuar që, siç ta jepte brenda një çasti, po atë çast e kapërdinte vetë.

Në kryqëzim, ku më duhej të kthehesha majtas, gjeta sinjalin e kuq, çka ma përforcoi paragjykimin se prefektin nuk do të arrija ta takoja. Por nga portieri mësova të kundërtën, zoti Manzurani sapo kishte ngjitur shkallët. Ai kthehej nga qyteza e minierës, ku kishte negociuar me sindikalistët dhe ia kishte dalë të pezullohej marshimi i minatorëve, që donin ta mbështesnin protestën.

Më priti me këmbët e para. Ai njihej si njeri që, nganjëherë, e tundte kokën edhe pa kuptim. Mirëpo kur nxehej, shpesh e gozhdonte kundërshtarin me logjikën: “Kuptimi yt nuk është kuptimi im. Kaq dhe mbaroi!”

Sapo më pa i ndërroi çehrrja. Entuziazmi, me të cilin ishte kthyer nga minatorët, iu fik. Si ta kishin shtyrë susta nga poshtë, e lëshoi kolltukun dhe duke tundur gishtin, më paralajmëroi:

- Valer Jaca, ti vërtet ke në damarë gjak burgasi, por ujë e ke bërë me ato paçavuret në gazetë. Kaq dhe mbaroi!

M’u duk sikur po më zbonte nga zyra dhe më erdhi t’ia mbathja, duke përplasur derën. Megjithatë qëndrova ca ballë për ballë, për të verifikuar dy vëzhgime nga takimet e mëparshme. Përse ky burrë

kishte gjithnjë në fytyrë ca puçrra aq të njoma, sa dukej sikur i kishte shtrydhur vetëm pak minuta më parë?! Dhe i dyti, për shkak të dhimbjes në kërbishte, gjatë qëndrimit më këmbë Sazan Manzurani i mbante duart shpesh pas kurrizit. Nëse këtij pozicioni të krahëve i shtoje edhe pamjen e trembur të fytyrës, të krijohej përshtypja sikur nga çasti në çast nuk priste tjetërkënd, veçse njeriun që do të vinte për t'i hedhur prangat.

Nuk m'u dha kohë për verifikimin dhe dola pa e përplasur derën. Por as kuptimi i tij dhe as moskuptimi im nuk do të mbaronin me kaq. Mos, vallë, do të puqeshin një ditë?

Kishte rënë mbrëmja kur, pasi dërgova shkrimin me postë elektronike, vajta në hotel “Sacher”, me mendjen të pija ndonjë aperitiv dhe të bëja një dorë muhabet me kolegët. Me të shkelur në holl, dëgjova një zë nga portineria, dikush ka lënë një zarf për ju, zoti Jaca. Nxora kartolinën, e kundrova një grimë dhe pashë se, me shkrim dore, kishte tekst në shpinë: “Meqë gjatë javës, në darkat që hëngrëm bashkë, nuk mora asnjë propozim prej teje, *alora* ja propozimi im. Por kujdes, përmbushja e tij kërkon dy PO. A më dëshiron? A je i gatshëm të vish në Itali? Duke të dhënë bekimin tim, Antonella B.”

Në portineri mësova gjithashtu se disa të huaj e kishin lënë hotelin dhe ishin nisur me urgjencë për në Rinas, me shpresën që të kapnin avionët e fundit. Ia kisha numrin e celularit dhe po aty, nga holli, i dërgova Antonelës një mesazh. Pa më shkuar fare nëpër mend çfarë mund të ndodhte në të ardhmen, iu përgjigja me një PO dhe një JO.

Vallë, aq naiv isha treguar sa, i marrosur pas punës, nuk e kisha pikasur dëshirimin e saj?! Mirë në restorant, sepse i mbaja sytë të pjata, po afër mesnatës në qoshe të barit, kur dritat uleshin dhe në tryezën

me qirinj të kuq ne pinim sambuko, teksa muzika dëgjohej butë në sfond. Ndjeva se Antonela Boeti më kishte shpëtuar nga dora si një *farfalla*. Dhe ishte flutur e bukur. Sidoqoftë, i dhashë dum me vete, flutur stinore është dhe unë nuk jam mashkulli migrator, që të vrapoj pas saj. Aq më tepër që isha në pikun e pasionit për gazetarinë.

Kur fillova punën në Par-Mer (shkurtime të Paralele e Meridiane), më shkante mendja nganjëherë te Dino Buzzati. Megjithëse ishte aq i lakmuar në *Corriere della Sera*, për disa kohë kishte pyetur veten: “Kur do të më zbojnë si një qen?” Vonë m’u fashit pasiguria edhe mua, sepse duke qenë gazetar terreni, rrallë më binte në vesh ndonjë fjalë e mirë nga shefat. Ndoshta prandaj u habita kur, në prani të kryeredaktorit, drejtori më thirri në zyrën e tij për të më komunikuar emërimin redaktor. Madje shtoi, do t’i gjendesh në krah kryeredaktorit edhe për kujdestarinë e titujve. Intuita dhe shija jote letrare na kanë rënë në sy vazhdimisht.

Kur u thirra herën e dytë, drejtori më shoqëroi në zyrën e pronarit të gazetës. Kohët e fundit kisha qenë disa herë me shërbim në Burgas dhe, meqë parashiheshin zhvillime të rëndësishme, më kërkoi të ngulesha atje për disa kohë si i dërguar special. Pronari nuk e përmendi faktin se ishte vendlindja ime, ai dha tjetër argument. Synimi ynë është që, për së shpejti, të bëhemi e përditshmja e dytë për nga tirazhi. Ne kemi varur shpresa të mëdha te puna jote, Valer, por edhe tek e ardhmja jote, tha zotëria e tij. (Nuk do të më flaknin, por do të më trajtonin qençe një ditë.)

Me drejtorin morëm ashensorin dhe zbritëm në katin, ku ndodhej redaksia. Teksa çapiteshim në korridor, drejtori më kujtoi historinë e një gazetari të huaj, të cilin e dërguan diku larg, për t'i ndjekur në terren ngjarjet dramatike. Mirëpo ç'bëri gazetari? Ai shkroi një libër, me të cilin fitoi *Pulitzer Prize* dhe u bë i famshëm gjithandej.

- Valer, - më zuri për krahu drejtori, - ma lejo një këshillë miqësore. Beso te stili dhe shija jote. Prandaj mbaje ndezur një dritë për të ardhmen. - Pastaj u ndal te zyra e financës, duke i kujtuar nëpunëses porosinë: - Evelina, për Valerin siç ka urdhëruar pronari.

Sapo hyra, Evelina Sako hapi krahët duke buzëqeshur, thua se edhe donte të më puthte, edhe po shprehte habi si po ndaheshim ashtu. Nuk e di ç'illuzione kishte në kokë, ngaqë unë isha beqar. Pa rënë në sy të redaksisë, prej disa muajsh kishim marrëdhënie intime. Herën e parë bëmë dashuri thujse rastësisht. Herë të tjera me takime të menduara. Seksi i fundit kishte ndodhur të djeshmen.

Ajo e kishte të shkruar urdhrin e pronarit. Paga ime mujore rritej me pesëdhjetë për qind, ndërsa të gjitha shpenzimet në Burgas (ushqimi, hoteli, karburanti etj.) përballoheshin nga redaksia. Nënshkrova për paradhënien, kur Evelina Sako po thoshte se kështu ndodh nganjëherë, çfarë sjell minuta nuk e sjell as moti.

Pikës i kishte rënë, sepse edhe minutat që qëndrova në hollin e hotel "Sacher", do të sillnin një ndryshim të papritur.

## 6

Me kartolinën e Antonelës në xhepin e brendshëm, në vend të nisesha nga bari për të takuar kolegët, vajta në restorant. Kisha bërë shfletimin e menysë, kur dëgjova ca kërcitje takash. Nuk e njihja zonjushën që po afrohej, por mënyra si m'u drejtua, më mbërtheu përnjëherësh. Ajo mbështeti dorën në shpinën e karriges sime dhe foli duke ruajtur atë profil, si të besonte se unë dëgjoja vetëm nga ai vesh.

- Më është dashur të pres radhën me durim, Valer. Madje prita një javë rresht, që t'ju ftoja për darkë. Jam Floreta Sako, motra e Evelinës.

O Zot, përse s'ma kishte thënë Evelina se kishte një motër në Burgas?! Dhe përse, pastaj, ma kishte përgatitur vetë këtë surprizë?! Ishte fort shpejt për t'i thënë vetes prit, or kalorës, se je ende në fillimin e fillimit, mendja s'ta rrok prognozën e mbarimit.

Për të ma hequr kërshtërinë, Floreta m'u hap me t'u ulur. Pas studimeve universitare dhe masterit, kishte qëndruar disa kohë pa punë. Pastaj kishte marrë pjesë në një konkurs të Ministrisë së Drejtësisë, ku kishte dalë fituese. Ja, pa shumë mëdyshje, e lashë kryeqytetin e zhurmshëm dhe erdha në Burgas. Ka

rreth njëmbëdhjetë muaj që jam psikologe në burgun e grave, e mbylli paraqitjen me një vdirje të syve.

“Më iku një flutur, më erdhi një flutur. Por kjo s’qenka e bukur”, m’u nëpërmend pa dashje e pa zë. Ajo përhumbje sysh m’u duk e tejkualuar sot, kur vajzat të shohin drejtpërdrejt pa iu dridhur qerpiku, madje nganjëherë me aq furi, sa duken të gatshme ta ngrenë fustanin aty për aty, ose me aq zemërim, sa të mos përtojnë me t’i dhënë veshët në dorë. Ishin jashtë zakonisht tim trysni të tilla perverse, por ndoshta qe kombinim rrethanash. Madje, teksa tregohesha më i vëmendshëm, vëreja se kishte edhe veçanësi tërheqëse. Me gjasë, atë farë vagëllimi të syve e kishte të natyrshëm, sepse sa herë përsëritej, shfaqej njësoj. Por e veçantë ishte edhe çuka e gushës, kishte diçka nga vatra e mollës. Dhe ky vrojtimi i fundit më dha habi me veten. Sepse nëse kishte një tipar që më rrëshqiste nga fytyrat njerëzore, ishte forma e gushës.

E pyeta se çfarë pritej nga ardhja e Ministrit të Brendshëm dhe ajo m’u përgjigj:

- Mua më ndalohet të flas, por po them vetëm kaq. Midis palëve, të burgosurve dhe qeverisë, ekziston një konflikt i papërfunduar. Dhe kjo e mban pezull gjendjen.

- Është e mundur që forcat speciale të hyjnë sonte nëpër fjetoret e të dënuarve dhe të ushtrojnë dhunë? Makar dhunë verbale?

Meqë nuk isha ndalur pas pyetjes së parë, u vu në siklet. Por nuk më hoqi vërejtjen, gjeti mënyrën që “kërshërisë” sime t’i vinte rrotull përmes profesionit.

Nevoja e sigurisë së grupit brenda një territori të caktuar është e njohur botërisht, Valer. Sipas etilogjisë çdo shtazë, duke përfshirë edhe njeriun, e përcakton territorin e vet. Ndërhyrja në atë hapësirë konsiderohet agresion. Prandaj, në situata të tilla, zakonisht vihet në lëvizje mbrojtja grupore.

Diç më mbeti në mend, sado m'u duk se kishte folur me fraza të gatshme, që kushedi në ç'tekste i kishte mësuar. Nuk do ta dija kurrë nëse edhe temën e masterit e kishte bërë vetë, apo ia kishte shkruar ndonjë *zezak* me pagesë.

Nga droja mos ma lexonte mendimin me telepati, sajova një buzëqeshje kot së koti. Ajo zgjati gotën gjithë çiltërsi për çin-çin. Nuk ishte vetëm çiltërsi, por edhe mirësi. M'u tipos se, megjithëse ende zonjushë, fytyra e saj kishte diçka mëmësore. Mos i vinte nga vera ai kuqëlimi i lehtë? Sidoqoftë, i kishte rënë një vesk shtatzënie dhe, kur ia thashë, u shkri së qeshuri.

- Si po e sheh tek unë mëmësinë, pa parë ende vajzërinë?! - ma ktheu me pecetën në shtjekat e buzëve.

Kur mbaruam darkën, pandeha se do të ndaheshim në holl. I thashë se kisha dalë pa makinë, përndryshe do ta shoqëroja.

- S'ka gjë, - tha ajo, - të shoqëroj unë. Kam parkuar afër hotelit. Ndoshta më fton edhe në dhomën tënde për ndonjë amaro, se unë nuk pi sambuko.

Hej drej, çka t'i thosha? Në frigon tim vetëm pije të forta kisha. Dhe pastaj çfarë, do të përfundonim në shtrat? M'u kujtua Antonela, por edhe Evelina, që



nuk binte më poshtë se italiania. Mirëpo, në rrethanat me Floretën, m'u desh prapë t'i jepja dum me vete, kur s'ke pulë, kënaqu me sorrë.

Drejt Shtëpisë së Beqarëve, thashë në makinë si nëpër dhëmbë. Po, po, e dija nga ime motër se je beqar. Vëre rripin edhe ti, Valer, është masë sigurie. Por në të vërtetë, unë po ndihesha i pasigurt me veten. Nuk ishte çështje rripi. Pasiguria më vinte nga dyzimi i brendshëm. Si dreqin kisha lejuar që një psikozonjushë të më lidhte aq shpejt pas vetes, sa t'i bindesha kokulur?! Ku djallin po e çoja, pse duhej ta mësonte një punonjëse burgjesh banesën time dhe sidomos pa qenë i përgatitur?! Po sikur në mëngjes, kur kisha hequr pizhamet, t'i kisha fluturuar mbi krevat?! Madje edhe krevatin e përfytyrova me mbulesat e mbledhura gollomesh.

Në atë godinë katërkatëshe dikur flinin minatorë e nëpunës të rinj, ende të pastrehuar me banesa. Pas privatizimit, ndoshta për ndonjë përfitim tatimor, nga Hoteli i Beqarëve pronari e regjistroi si Shtëpia e Beqarëve. Dhe në fakt të gjithë ishin qiramarrës. Në restaurim e sipër, duke u bashkuar dy dhoma, ishin krijuar apartamente të vogla, që parapëlqeheshin nga çiftet fillestare apo familjarë në vështirësi. Por ishte bërë edhe një ndryshim ndërtimor. Dy apartamentet skajore të katit të katërt i kishte kthyer në dubleks, duke u shtuar nga një kat mbi tarracë. Dubleksin e krahut të djathtë, ku kishte investuar më tepër dhe që intimisht e quante Eklips i Plotë, pronari e mbante në

rezervë private. Dhe meqë Blinor Disha ishte shoku im i gjimnazit, kur shkoja në Burgas, ma ofronte bujarisht. Në këtë suitë, bënte hajgare me mua, ke voli edhe për qetësi, edhe për dashuri. Por një javë më parë më kishte thënë ndryshe, kësaj here eklipsi është i pjesshëm. E përse? Nuk m'u përgjigj, duke ma lënë enigmë.

Nuk qe e nevojshme t'ia tregoja Floretës rrugën më të shkurtër drejt Shtëpisë së Beqarëve. Tashmë në Burgas ajo ishte bërë më vendalie se unë. Madje te kthesa e butikut Gëzimi i Syrit ajo tha, këtu ka ndodhur kacafytja e dy kunatave, që për qytetin vlerësohet ndër ngjarjet më të rënda në dekadën e fundit. Mbasi dolëm nga makina, s'na mbetej veçse të ngjisinim shkallët. Në korridor vëreja prirjen e saj për të ecur para meje. Pastaj u habita kur, duke rrëmuar në çantë, ma zuri derën me trup. Vetëm një çast dhe, trak-trak, kërciti brava. Me t'u hapur dera, krejt e sigurt, zgjati krahun në anë të murit për dritat.

- Kjo është gjysma jote, Valer. I sheh shkallët? Ato të çojnë në gjysmën ku ka eklips dhe ku banoj unë.

Më kot isha drojtur, asgjë të parregullt nuk më zuri syri përreth. Veçse nuk mund të thosha se cila ishte dora, që kishte vendosur aq paqe, deri edhe margarita në vazon e tryezës. Një gjë kuptova shpejt, bashkëpunëtorët e kësaj surprize e njihnin skenarin fije për fije. Floreta hapi frigoriferin dhe nxori një shishe Amaro Dissarono. Për mua pak konjak, thashë. Të tjerat u ngrita për t'i shërbyer vetë.

Kur shkoi sipër, nuk mbaj mend nëse ia vuri çelësin derës së saj nga brenda. Kujtoj vetëm se, teksa ngjiste shkallët, nuk ma mbushën syrin vithet petashuqe. Por në shtrat, me kokën e mbështetur në dy nënkresa, e qortova veten për këtë paragjykim maskilist. Ama, nuk isha krejt esëll, sepse brufma e xixave nuk kishte pse të dilte nga tavani, xixat prafullonin nga sytë e mi. Mundohesha të kuptoja skenarin e kurdisur, sidomos motivin e tre autorëve. Çfarë e kishte shtyrë Evelinën, e cila kishte iluzionin se një ditë mund të martohej me mua? Kishte dashur ta përdorte të motrën si ombrellë mbrojtëse, si hafije, apo si karrem për të zbuluar vanitetin tim? Një mendje më thoshte se, në tërë këtë “rrethim”, një pikë e kishte shquar qartë. Në praninë e Floretës, unë do të isha një subjekt për t’u studiuar nga psikologjia, njëfarë kavie eksperimentale. Ndërsa për Blinor Dishën, me atë mendjen ku rafsha mos u vrafsha, kurdisja mund të kishte qenë me natyrë altruiste. I thanë, e pranoi. Pse jo, shijimi i një aventure enigmatike nga miku i tij.

Kur ula kryet, sado u përpoqa ta hiqja mendjen nga psikozonjusha, më mbajti peng gjatë ajo përgjigjja e saj për konfliktin e papërfunduar mes të burgosurve dhe qeverisë. Në raste të tilla, kishte shtuar pak më vonë, kujtesa e secilës palë ka tregues të qartë për përjashtimin e kundërshtarit dhe jo integrimin e tij.

Çfarë pritej të ndodhte të nesërmen me ardhjen e Ministrit të Brendshëm?

Ai mbërriti aq herët në mëngjes, sa në vend ta shihnin helikopterin duke zbritur, shumica do ta shihte vetëm kur të ngrihej për t'u kthyer në kryeqytet. Por gazetarët që flinin në Sacher, e dëgjuan zhurmën në pistën e çatisë. Me nazet për t'u ndezur, mua më vonoi ca makina, megjithatë arrita në kohën, kur disa kolegë e kishin zënë tashmë portikun e hotelit. Ministri Ahmarini nuk mund të na shpëtonte nga sytë, sepse prej aty i mbanim në kontroll dyert vetëlëvizëse.

Pa zbardhur ende drita, rrjetet sociale ishin mbushur me gjithfarë lajmesh, pseudolajmesh dhe parashikimesh. Por njoftimi i pushtetit lokal ishte më i besueshmi. Sipas tij, zoti Dilaver Ahmarini dëshironte një bashkëbisedim me qytetarët e nderuar të Burgasit. Ai priste t'i takonte në orën 17:00 në Pallatin e Sportit. Mirëpo se çfarë do të bënte deri atëherë dhe çfarë pritej nga takimi i mbasdites, njoftimi nuk e thoshte. A mund t'i thoshte vetë ministri?

Unë e njihja Ahmarinin. Kisha pasur rast ta takoja nga afër në kokteje zyrtare, në konferenca shtypi apo pritje që bëheshin për të huajt. Sado që mua nuk

pranonte të më jepte intervistë (“Je i hidhur dhe dinak!”, më kishte thënë në një takim.), një bisedë më afruese kishim pasur në ambasadën amerikane, në një rast të festës kombëtare. Gjithë kohën që më kushtoi, katër ose pesë minuta, mbante nën vëzhgim ambasadorin, në mënyrë që t’i qasej në çastin më të përshtatshëm. Po ta kishte ditur ç’ë priste, do t’i kishte rënë shpejt ajo ethe. Pas përshëndetjes së mirësjelljes, ambasadori i kujtoi menjëherë pakënaqësinë e Departamentit të Shtetit për përhapjen e kanabisit, duke e mbyllur me fjalët: “Si kështu, zoti Ahmarini, vetë policët kanë parcela?!” Por informacionet sekrete të CIA-s nuk ia përmendi. Dyshohej se Ministri i Brendshëm kishte krijuar *under ground* edhe një drejtori të posaçme në dikasterin e tij. Në mos gabohem, në rrethe të ngushta ajo quhej Drejtoria e Sterilizimit, e cila merrej me zhdukjen e provave dhe pastrimin e gjurmëve të krimit.

Mirëpo Kryeministri, i ndodhur në krah të ambasadorit, e hoqi shpejt barrën nga supi i tij, madje me ca ironi: “Policë me parcela kanabisi?! Po habitem, Dilaver, ma paske fshehur informatën këtë herë!”

Për marrëdhëniet e tyre qarkullonin gjithfarë thashash. Flitej se në një mbledhje të Këshillit të Ministrave, ku zoti Ahmarini kishte bërë një apologji të gjatë për ministrinë që drejtonte, pakënaqësinë e tij Kryeministri ia kishte shprehur në fund me këto fjalë: “Ç’i ke ato buzë si fije bari, mor Dilaver? Ngaqë flet shumë, mos i ke ngrënë vetë me dhëmbët e tu?!”

Dhe vërtet, aq të holla i kishte buzët, sa po t'ia bënte portretin një piktor, për formën e gojës mund të mjaftohej me një vizë. Ai ishte vetullan, me flokë të ngjeshur, me qime të forta e të grinjta, që të kujtonin telin e kaluar në limë. Pikërisht për shkak të vetullave, këtij tipari që merrte tërë vëmendjen, nuk binin në sy as buzët e holla, as hunda e shtypur. Por bashkëpunëtorët që e njihnin mirë, pikërisht për hundën e shtypur pëshpërisnin mbas shpinës së tij: “Është mësuar të hajë grushte nga Shefi!”

Teksa prisnim, pamë se makina e ministrit (ishte parkuar në Rajonin e Policisë) hyri në oborrin e hotelit. E njohëm lehtësisht nga targa. Meqë te portiku dolën edhe truprojat, e nuhatëm se kishte ardhur çasti. Kaloi vetëm një grimë dhe, në shoqërimin e kryebashkiakut e të prefektit, Dilaver Ahmarini doli nga ashensori. Pata kohë ta vëreja duke përshkuar hollin. Gjithnjë po ai trup rrëshqitës që, me të hedhur hapin, i shkonte herë majtas e herë djathtas, thua se brenda ishte i ujshëm.

Ndërkaq, ndërsa pinin gotën e fundit në orët e vona të natës, dikush kishte mundur që këshilltarit Aviduli t'i zhgrapte një intimitet. Të mbrëmshmen kishte pasur një bisedë telefonike me ministrin. Kur ai e kishte pyetur si ishte gjendja në Burgas, këshilltari ishte gjegjur, si mos o Zot më keq! Mirëpo, si të mos donte të dinte as vetë më tepër, Ahmarini e kishte qetësuar: “Çdokush ka një kufi për trurin, ndryshe luan mendsh. Tashmë unë ia vura kufirin këtij timit, stopoje tëndin edhe ti, Zihni Aviduli.”

- Zoti Ministër, zoti Ministër! - u dëgjuan njëherësh thirrjet e reporterëve, duke synuar ta ndalonin patjetër.

Dhe ai, duke folur në kalim, tha veç dy fjalë që na kllaposën menjëherë:

- Do të ketë zhvillime të reja. Nuk është nevoja ta përsëris, zhvillime të reja.

Kur po ia hapnin derën për të hyrë në makinë, më pikasi midis të tjerëve dhe shikimet tona u kryqëzuan. Ngaqë uli vetullat, vështrimi sikur iu ftoh nën ato streha. E mora me mend se, tashmë, i kishte shfletuar gazetat dhe nga gjithçka që ishte botuar, shkrimi im kishte qenë më përvëluesi. M'u duk sikur po më thoshte: "Ti je i hidhur dhe dinak. Prandaj stopoje trurin përgjithmonë, Valer Jaca, intervistë prej meje kurrë nuk do të kesh!"

## 8

Në zanatin tonë, nganjëherë, bëjnë punë edhe nuhatja e langonjve, edhe vrapi i tyre. Por në këtë rast ishim fatlumë, ne e kishim “gjahun” para syve. Tri makina (Mercedesi i ministrit në mes) dhe dy motoçikleta të uniformave në krye. E pranoj, në rrethanat e turbullirave na u duk e natyrshme që ministri shoqërohej me eskortë të përforcuar nga komisariati i Burgasit. Por na u duk i papranueshëm rrengu, që na ngriti policia rrugore. Pa bërë ende treqind metra, i gjithë grupi i ndjekësve u ndalua, gjasme për një kontroll rutinë të dokumenteve. Por, prapëseprapë, zoti Ahmarini nuk shpëtoi dot pa u fotografuar dhe filmuar. Ca reporterë e fotoreporterë të tjerë e kishin nuhatur në ajër se për ku ishte nisur, prandaj kishin marrë rrugë tjetër, duke e pritur zotërinë mu para dyerve të korpusit.

Më pas, kur u bashkuam me kolegët, të gjithë ramë në një mendje, ishte e logjikshme që Ministri i Brendshëm ta fillonte aksionin pikërisht aty, ku rendi e qetësia ishin prishur. Se ç’ndodhi pastaj, nuk m’u desh shumë kohë ta mësoja. Ai takoi grupe të



burgosurish. Ca në sallën e mensës, ca në oborr dhe ca në kthinën e bibliotekës. Kërkoi paqe apo vringëlloi dhëmbët?

Ministri Ahmarini e kujtonte mirë një bisedë për Burgasin e urtë, siç e cilësonte nomenklatura e lartë. Ai e kishte të freskët kujtimin, sepse biseda me kryezotin e tij, Kryeministrin, kishte ndodhur vetëm pak muaj më parë. Meqë dikur ky qytet kishte nisur në fushëgropë nga hiçi, mendohej se ruante në gjene diçka nga shterpësia e hiçit. Burgasi ishte beniamini i Kryeministrit. Për aq kohë sa ishte në krye të qeverisë, njëlloj si nën qeveritë e tjera, kurrë s'i kishte nxjerrë telashe as për ambiciet e veta, as të opozitës. Andaj, teksa fërkonte duart, i tha ministrit: “Është për t’u habitur, por Burgasi ka qenë dhe mbetet qytet pëllumbash!” Duke dashur t’ia përkëdhelte sedrën Shefit, ndryshe nga sa bluante me vete, Dilaver Ahmarini ia ktheu: “Si urdhëroni, paqe duan këta pëllumba!” Me vete po bluante njëfarë inati të çuditshëm se, në raport me pozitën e tij, ai qytet e kishte lënë pa punë, çka do të thoshte edhe pa ndonjë fjalë të mirë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave.

Kurse rreth dy vjet më parë, prefekti dhe kryebashkiaku i kishin dërguar qeverisë një letër të përbashkët. Në të mirë të argumentit të tyre, letrës i kishin bashkëngjitur edhe statistikën e fundit mujore të një organizate civile, e cila ishte kundër “mbushjes së hambarit” përtej kapaciteteve. Brenda tridhjetë ditëve të atij muaji, në korpusin e Burgasit ishin sjellë 32 të

dënuar për tubime të paligjshme dhe kundërshtim të rendit me forcë; 17 për bllokim të rrugëve, djegie dhe ndotje të ambientit; 29 të dënuar për ngarje makine në gjendje të dehur; 26 për armëmbajtje pa leje; 18 shpërndarës droge nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç; 32 për mospagimin e faturës së energjisë elektrike; 14 për dhunë në familje, etj.

Por vetë zyrtarët lokalë kishin synuar edhe më tepër. Në letrën e tyre ata i kishin kërkuar qeverisë jo vetëm të ndaloheshin prurjet e të burgosurve nga qarqet e tjera, por mundësisht të fillonte zbrazja e korpusit, duke bërë transferime në të kundërtën. “Është e qartë”, shkruanin ata, “se prania e tri burgjeve këtu ka të paktën tri pasoja. Një, i vënë njollë emrit të mirë të qytetit. Dy, bëhen nxitje për të kryer krime, sidomos krime të vogla, ngaqë ata që janë brenda kanë nevojë të krijojnë marrëdhënie të pista me ata që janë jashtë. Dhe tre, ne jemi të gatshëm të betohemi me dorën mbi Kushtetutë për ndershmërinë e qytetarëve të Burgasit, pasi në qytetin tonë mbizotëron morali i shëndoshë. Përfshirja e vendasve që vuajnë dënime penale është kaq e papërfillshme, sa nuk ia vlen as të citohet. Ne ju garantojmë se, po të çrrënjosej prej këtu *foleja e grerëzave*, Buragasi mund të shpallej si qytet model pa krime, me një fjalë, njëfarë kryeqyteti europian i pastërtisë penale.”

Ende pa dalë nga korpusi Ahmarini, e mësuam qëndrimin që kishte mbajtur në sallën e mensës, në oborr dhe në kthinën e bibliotekës. Ai u kishte kërkuar

ndjesë të burgosurve dhe i kishte ftuar ta ndërprisnin grevën e urisë, pasi kushtet e vuajtjes së dënimit do të përmirësoheshin për së shpejti. “Erdhi si me krahët e pëllumbit, kishte paqen me vete”, shtoi Floreta, kur ma konfirmoi informacionin e burimit anonim. Kësaj here u shpreh lirshëm, madje duke huazuar edhe këshilltarin Aviduli, pasi lajmi i mirë nuk cenonte kodin e detyrës.

## 9

Ndonëse kishte ende kohë deri në orën e takimit publik, vala e psikozës kolektive nxori në rrugë një rungajë qytetarësh. Kaq lëvizje vetëm dy herë mund të shiheshin gjatë motit, në derbin e futbollit mes dy ekipeve të Burgasit, si dhe në festat e fundvitit. Hamendësimet për takimin me ministrin ishin kontradiktore. Thuhej se aktivistët e shoqërisë civile, duke qëndruar më këmbë e duke këlthitur, nuk do ta lejonin të mbante fjalim. Tashmë ata i kishin ndarë edhe detyrat. Trimoshët do ta gjuanin me vezë dhe do ta spërkatnin me spraj, trimëreshat do ta gjuanin me këpucë. Të tjerë ishin të preokupuar për të kundërtën. Ata vrisnin mendjen se çfarë do t'u thoshte ministri. A mund të ishte aq i zemëruar, sa organizatorët e protestës në shëtitore të arrestoheshin në shkallët e Pallatit të Sportit?!

S'e kujtoj mirë sa herë e pashë Nevil Zusin, Zeusin e prokurorisë, teksa përshkonte qendrën e qytetit. Me trupin hollak, ai çante përmes njerëzisë si kaike, duke lënë pas një vazhdë vibruese ajri. Prokurori dukej shpesh edhe në korpus. Atje kishte një zyrë të

posaçme, ku merrte në pyetje të burgosur, sa herë që emri i tyre dilte gjatë ndonjë hetimi, kudo që bëhej ai. Në të vërtetë, shpesh ushtronte edhe trysni, për t'i kthyer të burgosurit në informatorë të brendshëm. Mjerë ai që përballtet me shikimin e tij të errët, ofshante kush e kishte provuar, në sytë e atij njeriu sikur nuk ka bebëza, por hone. Aleko Samara, i dënuar me katër vjet heqje lirie, pasi ishte thyer në zyrën e prokurorit dhe kishte nënshkruar një dokument, ra në stres të rëndë. Brejtjet e ndërëgjegjes e çuan në vendimin për t'i dhënë fund jetës. Mirëpo shërbimi mjekësor e shpëtoi sak në çastet, kur kishte nisur të nxirrte shkumë nga goja. Fjalët e para që tha më pas, ishin: “Unë më mirë ha sapun, sesa të bëhem spiun!”

Herën e fundit e pashë prokurorin në mes të sheshit. Ishte me pronarin e Fabrikës së Bimëve Mjekësore. Vlash Llazarani ishte i njohur në Burgas jo vetëm për ndershmërinë, por edhe bujarinë e tij. Çdo vit, për dy bajramet dhe dy të kremtet e krishtera, bënte katër donacione në spitalin publik të fëmijëve. Natyrisht, këtë fakt e kisha raportuar në gazetë dhe ai tregonte miradie ndaj meje. Te sheshi i pata fare afër, sa nuk mund t'u shmangesha. Aq më tepër që isha kureshtar të dija përse po flisnin. Vlashi ma ktheu përshëndetjen edhe me gojë, edhe me gjuhën e trupit, ndërsa prokurori me atë buzëqeshjen fluturuese, të cilën në çast ma dha, në çast e gëlltiti po vetë. Për takimin me ministrin flisnin. Por ndërsa biznesmeni do të ishte i pranishëm, kushedi për çfarë arsytimi, prokurori do të mungonte në sallë.

Ishte parashikuar që Pallati i Sportit nuk mund t'i zinte të gjithë pjesëmarrësit. Prandaj, të mbrëmshmen, ishte hedhur mendimi që takimi të bëhej në stadium. Por vetë ministri kishte qenë kundër. Me një turmë stadiumi si mund të kishte takim të organizuar?! Ky nuk është koncert, por bashkëbisedim, ishte shprehur. Dhe prefekti Manzurani e kishte përforcuar menjëherë: “Zoti Ahmarini nuk ka ardhur për të kënduar, por për të ligjëruar.”

Megjithatë, bashkia e qytetit mori masat e saj. Në të katër këndet e Pallatit të Sportit u vunë altoparllantë, ndërsa në dy brinjët anësore edhe monitorë të mëdhenj, pasi tri kanaleve televizive u qe dhënë leja për transmetim *live*. Doli se këto masa kishin qenë me vend. Turma që u mbledh rreth pallatit, ishte shumë më e madhe se pjesëmarrja në sallë. Por meqë çfarë bëhej brenda dilte jashtë, pati një njehsim të habitshëm. Brohoritmave të ekranit u shtoheshin sinkron edhe brohoritmat e turmës, kështu që tërë qyteti dukej sikur oshtinte. Por njehsimi shoqëroi edhe dialogët. Sa herë që ministri shtronte ndonjë pyetje, përgjigjja që jepte salla mbështetej menjëherë nga turma. Dhe gjëmimi shpërndahej sërish në qytet.

Kësaj here gazetarët nuk u penguan, madje për ne u rezervua shkallarja e parë në të djathtën e panelit.

Kur prefekti që hapi takimin, ia kaloi fjalën ministrit Ahmarini, unë pashë orën. Prej zakonit që kishte për të folur gjatë, doja t'ia masja kohën. Tryeza e panelit, përveç mikrofonit të qendrës së zërit, ishte plot me regjistrues e mikrofonta të reporterëve. Diku aty ishte edhe diktofoni im. Por kisha merakun se nga njëri krah kasete mbante vetëm dyzet minuta. Hiçgjë për atë zotëri! Mirëpo kurrë, kurrë nuk do të ma priste mendja se do të dilte aq ndryshe!

Me gjasë, ministri ndihej më lirshëm të fliste më këmbë. Sapo u ngrit, prefekti tundi kokën. A për miratim, a për t'i dhënë shenjë sallës, s'u mor vesh. Ai që dekodoi gjestin, ishte drejtori i korpusit, i cili u anua nga kryebashkiaku dhe diç i murmuriti. Ndoshta: "Hapja e këtij eventit me popullin ju takonte juve, zoti Kosturi, dhe jo Manzurani!" Nën dritën e projektorëve fytyra verdhane e drejtorit Ristani kishte marrë vërtet ngjyrën e mjaltit.

Por, çuditërisht, edhe më në siklet dukej vetë ministri. Mbas fjalëve hyrëse (Mirë se ju gjeta, zonja dhe zotërinj!), pati një ngecje të gjatë. Si pa dashje,

teksa lëpinte buzët e holla si fije bari, i hodhi skithi një vështrim këshilltarit Aviduli, të cilin e kishte në të mëngjër. Mos vallë pikërisht për ato buzët e rënda, të shpërvjelura përpara, po aq rezistente për të mbajtur llogo, sa për t'i fryrë edhe bilbilit?! Pata përshtypjen se prej ndonjë gjendjeje emocionale ende të pazbuluar, Ahmarinit i qe tharë goja, thua se gjëndrat të mos i prodhonin sekrecionet e njohura, por qiriç. Pastaj ndodhi e papritura. Asnjë retorikë, por gishti drejt e në plagë.

**Ministri:** A mendoni ju, qytetarë të Burgasit, se kushtet e të burgosurve janë jashtë standardit në korpus?

**Salla:** Ashtu mendojmë, janë për faqe të zezë.

**Jashtë:** Më ibret nuk kanë si bëhen!

**Ministri:** A mendoni ju se qeveria i ka fondet e nevojshme për t'u krijuar të dënuarve hapësirat normative të banimit dhe kushtet normale të jetesës?

**Salla:** Është detyra e qeverisë ta zgjidhë konfliktin.

**Jashtë:** Dhe po s'e bëri, shkel Të Drejtat.

Zoti Ahmarini heshti përsëri, veçse kësaj here disi meditativ. Ndërsa njërin sy e mbante nga tribuna e atij krahu, tjetri i shkonte përtej tavanit. Prandaj gjysma e fytyrës i krijonte pamjen e pranisë, gjysma atë të arratisë. Cilin po kërkonte me atë vështrim të përhumur? Më në fund, e nxori kokën prej reve dhe foli siç e lyppte rangu e ndera e tij.

**Ministri:** I autorizuar nga Kryeministri, unë kam ardhur me një zgjidhje, që po jua propozoj. A



pranoni ju që çdo qytetar, sipas mundësive, të marrë në shtëpinë e tij dy, tre a më shumë të burgosur? A pranoni ju që ata ta kryejnë në shtëpitë tuaja kohën e mbetur të dënimit?

Stepje. Ngritje supesh. Ndoshta mosbesim për çfarë po u zinin veshët. Ndoshta pandehma se ku do të dilte propozuesi, mos po kërkonte t’ua linte kopilin në derë?! Pastaj murmurima, zëra në rritje dhe shpërthimi.

**Salla:** Pranojmë, pranojmë! Është e pafalshme të mbyllësh sytë ndaj padrejtësive.

**Jashtë:** Këtë gjynah s’e fal as Zoti. Të mbyllësh sytë ndaj fatkeqësisë së tjetrit, është njëlloj si të hiqesh i verbër.

**Ministri:** Ahere e quajmë të mbyllur. Me të nisur procedurat e pranimit dhe masat në terren, në pak ditë Të Drejtat do të vihen në vend. Ju, qytetarë të Burgasit, nuk do të kenë më brejtje të ndërgjegjes, ndërsa të dënuarit do të kenë standardet.

“Pikë dhe mbaroi!”, murmuroi nën zë prefekti Manzurani.

Kur u kthye në suitën e hotelit, ministri kërkoi ta linin vetëm. Por mbajti aty këshilltarin Aviduli, ish-ushtarakun e dikurshëm që e njihte mirë taktikën dhe strategjinë. Prej tij do të rridhte pastaj ndonjë pikim mbi çfarë u tha gjatë telefonatës që pasoi. Duke dashur të ndërpriste thashethemet, Aviduli do të shkruante në Twitter: “Jo, nuk ishte Kryeministri që telefonoi i pari. Ishte vetë zoti Ahmarini, që e informoi Shefin menjëherë. Dhe kjo përbën një detyrim zyrtar.”

Kur e dërgoi Ahmarinin në Burgas me autorizimin për atë propozim, ka të ngjarë që Kryeministri të kishte qenë me nerva të nxehta. Ai nuk e shpjegonte dot si ishte e mundur që një qytet, ku votohej me shumicë dërrmuese partia e tij, të solidarizohej me rebelimin e të dënuarve, duke protestuar në rrugë kundër pamundësive të qeverisë. Andaj, i mbushur me mllef, vendosi t’i sfidonte: “Merrini në shtëpitë tuaja!” Qëllimi ishte që t’ua lëndonte sedrën e sëmure dhe bujarinë teorike, pasi ishte i sigurt se burgasit kurrsesi nuk do të strehonin burgaxhinjtë në shtëpitë e tyre.

Mirëpo, me gjithë habinë e tij, ja që kishin pranuar. Çfarë t'i thoshte ministrit tani, kur po ia jepte me urgjencë njoftimin në telefon?! Në këto rrethana, Kryeministri nuk mund të tërhiqej më, sepse çfarë do të mendonte populli për një burrë shteti, i cili e hante fjalën e dhënë?! Me një barrë të rëndë në shpatulla, "Le të bëhet!" - i tha vartësit matanë, thua se po urdhëronte të bëhej planeti i Tokës. Ç'është e vërteta, në këtë çast nuk i mungoi një ndriçim befasues i perspektivës, që gjithsesi nuk ia fashiti mëdyshjet. Mirëpo tashmë ishte vonë për t'i kthyer mbrapsht fjalët, që kishte nxjerrë nga goja.

Me të mbyllur telefonin, si të ishte stërpikur edhe ai prej vizionesh perspektive, ministrit Ahmarini i kaluan rrëqethje në trup.

- A thua mund të krijojmë një model europian? - pyeti këshilltarin. - Kemi përpara dy mundësi: ose shkëlqejmë, ose dërrmohemi.

Zihni Aviduli nuk u ndie. Por nga zhubrat në mbiballin e zhveshur la të kuptohej se diç nuk shkonte mes taktikës dhe strategjisë. Doemos, tjetri e pikasi dhe si ta kishte për ters, në mëngjes nuk e mori me vete në korpus.

Drejtori doli ta priste te porta. Ata u çapitën krah më krah përgjatë oborrit, Ahmarini me atë trupin si të ujshëm dhe kokën në re, ndërsa Todi Ristani pa ia hedhur fare vështrimin basenit të peshqve, sado që po kalonin ndanë tij. Merret me mend, greva ishte ndërprerë dhe tani gjithçka ishte gati për ballafaqimin

e fundit. Mbasi takoi përfaqësinë e adoleshentëve në kthinën e bibliotekës dhe atë të grave në mjedisin ku bëheshin punime dore, vajti në sallën e ngrënies për delegatët e burrave.

**Ministri:** I keni mbajtur veshët ngrehur, ë?!

**Zëra:** Poo!

**Ministri:** Dhe e keni mësuar tashmë, se ishte një lajm si krismë. Ju pëlqen?

**Zëra:** Shuumë!

**Ministri:** Dakord, veçse do të ketë kushte.

**Zëra:** Ç'kushte, zotëria juaj?

**Ministri:** Po ju kujtoj kryesorin. Nëse njëri nga ju provon të arratiset, ai do të ridënohet me burgim të përjetshëm. Por, dale-dale, nuk mbaron me kaq. Nëse dikush provon t'ia mbathë, edhe çdonjërit nga ju i rritet dënimi me dhjetë vjet të tjera. Pranoni?

**Zëra:** Pranojmë. Dhe nuk e diskutojmë!

**Ministri:** Ahere premtimi i qytetarëve, dëshira juaj dhe toleranca jonë demokratike duhet të kthehen në marrëveshje të shkruar. Ndërsa procedurat për çfarë i takon Parlamentit, do të fillojnë së shpejti.

E nisi thuajse bosh helikopterin. Gjithë heshtje e zyrtësi, rrugën e kthimit për në kryeqytet e bëri me makinë. E kishte zakon që, herë pas here, të shihte në pasqyrë rrotën e dytë, si të kishte dyshim për gomën e krahut nga rrinte vetë. Në të vërtetë, seç bluante përbrenda dhe vërtitja e rrotës veçse ia nxiste mendimet.

Me procedurë të shpejtuar, duke pasur edhe votën e opozitës, parlamenti bëri ndryshime në Kushtetutë, çka u reflektua edhe në Kodin Penal. Për votimin e njëzëshëm u tha se, përveçse në disa raste edhe familjarë ose të afërm, mjaft nga deputetët kishin në atë burg njerëz që kishin punuar për ata, prandaj ndryshimi i kushteve të vuajtjes së dënimit u shkonte për osh. Kurse për opozitën pati edhe hamendësime shtesë. U përfol se votoi zorile, ngaqë nuk donte ta humbiste atë elektorat, të tjerë pohuan se votoi me hile, për ta futur qeverinë në qorrsohak.

Menjëherë ra në sy një amendament në kompetencat e Presidentit. Atij iu hoq specifikisht tagri për amnisti në korpusin e Burgasit. Ndonëse pati juristë mospajtues, duke e marrë si hakmarrje ndaj avangardës së Të Drejtave, përgjithësisht u pranua si logjikë. Në rrethanat e reja të dënuarit nuk kishte pse të shpërbleheshin njëlloj, si në kushtet e mëparshme. Ndërsa qytetarët le ta mblidhnin mirë kaploqen, para se të protestonin shfrenueshëm për një objektiv. Meqë vullneti i tyre po plotësohej, ahëre ta paguanin deri në

fund edhe taksën e fitores, sepse Të Drejtat shkojnë bashkë me Detyrimet. Nëse ndokënd e kishte rrejtur mendja se, pasi t’i mbanin në shtëpi pak javë ose disa muaj, kjo praktikë do të merrte të tatëpjetën dhe të burgosurve do t’u hiqej (*abrogohej* - dorëshkrimi i T. Ristanit) dënimi masivisht, le ta dinin tani se me vite e vite aty do t’i kishin, nën çatinë e tyre. (Jashtë gjuhës zyrtare, kjo shprehej me aforizmin: “S’ë kanë parë ende bythën e viçit!”)

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë nisi puna për Rregulloren e Posaçme të fenomenit burgas. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve orientoi specialistët që të tregoheshin vizionarë, të parashihnin jo vetëm fillimin e fenomenit, por tërë zhvillimin perspektiv dhe çdo buloni t’ia shtrëngonin mirë vidhën e vet. Ky orientim, ashtu si aforizmi për prapanicën e viçit, vajti deri në korpus. Të pyetur nga drejtori Todë Ristani se çfarë mendonin për bulonin dhe vidhën, të burgosurit u shprehën se e pranonin plotësisht. Por midis tyre thoshin: “As që e rruajmë trapin tani se ç’mund të kurdisin baballarët e kombit dhe të korrupitit!” Atyre u dukej e gjatë fjala *korrupsion* dhe ia kishin gjetur shkurtimin me *korrupit*.

Unë nuk arrita të përmbushja një dëshirë të kryeredaktorit. Ai lakmonte që ta botonim të parët kontratën tip mes Drejtorisë së IEVP-së dhe qytetarëve strehues. E kisha të pamundur të siguroja çfarë nuk ekzistonte, sepse kontrata ishte ende në hartim e sipër. Megjithatë, për shkrimin e radhës sigurova disa nga paragrafët.

Që në krye, si të ishte ndonjë preambël, pala strehuese pranonte se do t'i përmbahej deri në fund zotimit dhe se vetëm vdekja mund ta çlironte prej kësaj kontrate. Strehuesi pohonte që në mjedisin e shtëpisë, ku do ta vuanin dënimin të burgosurit, do të bëheshin të gjitha ndryshimet e nevojshme dhe brenda afatit të caktuar. Nënshkruesi ishte i vetëdijshëm se do të zbatonte me rreptësi Rregulloren e Posaçme, e cila do t'i dorëzohej nga organi kompetent. Po ashtu, sipas kësaj dorëzanie, nënshkruesi nuk mund të strehonte një, por më e pakta dy të dënuar dhe gjithnjë të të njëjtit seks. (VO! Përcaktimi për seksin do të hiqej më pas.) Që nga çasti i nënshkrimit, nga person fizik qytetari bëhej person juridik, sepse kjo sipërmarrje ishte edhe njëfarë biznesi. Duke u përjashtuar nga tatimi vjetor, ai do t'u nënshtrohej të gjitha taksave të tjera të parashikuara në kontratë.

Po në këtë shkrim, arrita të zbuloja diçka edhe për kontraktuesin tjetër. Muaj për muaj pala zyrtare do t'i paguante strehuesit një shumë financiare, ku përfshiheshin kuota ushqimore, qiraja, shpenzimet për ndriçimin, ujin, higjienën personale etj. Në mënyrë që të arriheshin standardet, kjo palë merrte përsipër shpenzimet materiale për përshtatjen e mjedisit të burgosjes, ndërsa hakun e punës e paguante qytetari, se ai mbetej pronari.

Nëse kontrata prishej në mënyrë të njëanshme, parashiheshin sanksione. Siç m'u tha nga burimi, më i rëndi ishte: Kur prishej nga strehuesi, njëri nga

të burgosurit i kalonte një strehuesi tjetër, ndërsa në vendin e mbetur bosh, burgosej i zoti i shtëpisë. Ky do të ishte një penalizim për aq kohë, sa ç'i kishte mbetur nga dënimi të burgosurit që lëvizte. (VO! Edhe ky paragraf do të zëvendësohej më mbrapa me gjobë të rëndë financiare.)

Të nesërmen, me ta lexuar shkrimin në gazetë, mora një telefonatë nga prefekti. Zoti Manzurani po më ftonte për kafe. M'u duk më i ngrohur me veten, por edhe ndaj meje. E kishte ndërruar kostumin e përditshëm dhe mbante erë parfumi. Por s'di pse, ndoshta nga brisku që u kishte kaluar faqeve në mëngjes, ato puçrrat e vogla që ia ciknosnin fytyrën, dukeshin aq të njoma, thua se sapo ishin shtrydhur. Qerratà, buzëqeshi, gjithnjë me kariqin e peshkatarit i qasesh administratës së Burgasit! Në mos tre-katër, orë e çast ndonjë krap do të ngecë në rrethin tënd. Valer Jaca, e përforcoi zërin vetiu, ndoshta një ditë në qytetin tonë nuk do të ketë rrugë që ndan Të Pandershmit nga Të Ndershmit. Procesi i integritetit po fillon!

Sa për shkrimin, nuk kishte ndonjë vërejtje. Veçse tha se, po të isha konsultuar me zotërinë e tij, do të mund të kisha përfituar edhe një kuptim që, duke më munguar, krijonte moskuptim. Ç'është ky moskuptim? - pyeta. Në shkrimin tënd nuk thuhet se kush po punon për hartimin e Rregullores së Posaçme, u gjej. Përveç grupit të punës në kryeqytet, për disa kërkesa specifike të Burgasit po punohet edhe këtu.



Do ta dish kush e kryeson grupin tonë? Todi Ristani e kryeson. Dhe kjo ishte e pritshme, vazhdoi. Por e papritur ka qenë pjesëmarrja e dy të burgosurve si vëzhgues. Hë, a nuk i jep ky fakt më tepër kuptim tolerancës sonë?! Gjynah që kësaj here krapuliqi të ka shpëtuar nga kariqi!

Por nuk e lashë të më shpëtonte për shkrimin e së nesërmes. Atij edhe iu bë qejfi, edhe u vu në siklet, sepse informacionin e jepja duke cituar prefektin e qarkut, zotin Sazan Manzurani. Unë nuk jam nga ata burra që pështyj mbi nderin tim, do të më thoshte. Prandaj s'e mohoj, çfarë ke shkruar, me gojën time ta kam thënë.

- Valer Jaca, - u kujtua pastaj, - mos e bëj ujë gjakun burgas! Ty nuk të shkon të jesh idhnak e dinak.

Më vajti mendja menjëherë te ministri Ahmarini, i cili me siguri ia kishte injektuar opinionin e tij për mua.

## 13

Nuk e dija ende opinionin e Floretës. Vallë, çfarë isha në sytë e saj? Tërheqës, simpatik, ndoshta pak enigmatik? Ishte shpejt për ta thënë. Por shpresoja se një pyetje ia kishte bërë vetes: Cilat do të ishin marrëdhëniet mes nesh? Mos i shkonte mendja të më sillej si kumatë, kur isha dashnori dhe jo i fejuari i së motrës?! Njëfarë përgjigjeje do ta merrja rreth tri javë më pas, kur u lirua një hyrje dhe miku im, Blinor Disha, na tha të dyve:

-Tani vendoseni vetë. Në daçi bashkë, në daçi veç e veç.

Më tingëlloi ca e pistë mënyra si u shpreh, por i tillë kishte qenë qysh në gjimnaz, s'i mbante goja arra as para vajzave të klasës. Floreta nuk iu drejtua pronarit të Shtëpisë së Beqarëve, por m'u kthye mua, beqarit:

- Si thua, Valer, dy kate janë të mjaftueshme? E mbajmë bashkë dhe e paguajmë qiranë përgjysmë.

Por deri atëherë kishim pasur edhe ngjarje të tjera. Zakonisht nuk shiheshim gjatë ditës, mbrëmja na mblidhte nganjëherë. Por nëse më gjente me punë në kompjuter, s'i zgjaste përshëndetjet, më uronte natën e mirë dhe largohet, duke ngjitur shkallët sa më lehtë.

Një mbrëmje erdhi vetë i dytë. Kavalieri mbante në dorë një çantë ushqimesh dhe kuptova se do të hanin darkë së bashku. Ndoshta do të palloheshin përpara ose pas darke. Ndoshta edhe para, edhe pas. Punova deri vonë, por ai nuk u largua. Hamendësova se më kishte rrejtur gjumi dhe natën, me këpucët në dorë, kishte dalë duke tërhequr me kujdes derën, që kishte bravë automatike.

Në mëngjes Floreta zbriti vetëm dhe unë shestova se kavalierin, me të cilin kishte fjetur, e kishte lënë në gjumë.

- Ai është im vëlla, - tha. - Dhe pasi hëngrëm darkë e kuvenduam deri vonë, vajti në hotel.

- E si, me parashutë u hodh?!

Për fat, nuk e mori si provokim. Veçse shfaqti dy habi. Si nuk e dija unë që, pas një zjarri në katin e tretë, në brinjën e tarracës ishin shtuar shkallët e sigurisë. Zbritjen im vëlla e bëri për sport, tha. Habia e dytë? pyeta. Si nuk e ditke ti se ne kemi vëlla, ta ka thënë Evelina. Ma ka thënë, doemos. Por mendoja se ai, si vëlla, bënte punën e kujdestarit dhe jo të rojtarit, përderisa asnjëherë s'më kishte dalë përpara syve. Është e vërtetë, Valer, ai jeton më vete me familjen e tij, por kujdeset për ne.

Mbrëmjen e asaj dite, që prefekti ra në kariqin tim, e ftova të hanim bashkë një darkë të thjeshtë në gjysmën e eklipsit tim. Mjaftonte edhe ky emërtim që, në vend të llambave elektrike, të ndiznim qirinj në tryezë. Në çastin që u ngrit për të sjellë gotat, shëmbëllimi i saj buftoi përballë. Floretës sesi i erdhi dhe pyeti:

- Kur një hije zhvendoset nëpër mur, kush lëviz, muri apo objekti? - Pastaj, duke u zhvendosur vetë, shtoi krejt papritur. - Kushedi sa të madhe e bën hijen mali, Valer!

Në tërë atë shtjellë të ngjarjeve për korpusin, nuk e pikasa për kë po e hidhte fjalën. Për pushtetin që ka shteti, tha, për atë hije të rëndë po flas. Sado përpiqem t'i përfytyroj zhvillimet, nuk mundem. Vetëm një gjë e parashoh, jemi përpara një realiteti të rrëshqitshëm.

Floreta kishte kaluar një ditë të lodhshme. Ashtu si në burgun e burrave, edhe në atë të grave ndihej ndërrimi i atmosferës. Madje atje kishte pasur vizita edhe nga krerët lokalë të besimeve fetare. Ai i bektashinjve kishte shpërndarë gjithashtu karamеле me mjaltë e liker. Në orët e lira gratë ishin mbledhur sërish në sallën e aktiviteteve, por kësaj here s'dihej tamam përse: të qanin hallet apo të festonin? Ende pa u shpallur vendimi i transferimit, në mendjen e tyre depërtonte një frikë e beftë si acari i dimrit. Çfarë i priste te strehuesit, si do të silleshin ata, ishin të sigurt në duart e tyre? Për t'i lehtësuar rrëqethjet, ato më të rejat filluan të vallëzonin. Dikush u kujtua të shpallej një garë, cila prej tyre do t'i ngrinte këmbët më lart. U caktua kufiri, njërën këmbë deri prapa qafës. Ia dolën dy, tri, pastaj edhe e katërta. Marta Samrishi shihte e hahej me vete, po unë?! Ti jo, i thanë, ti nuk je e stërvitur për këtë ushtrim. Megjithatë Marta u ngrit. Ajo u tha shoqeve ta ndihmonin dhe ia doli. Veçse, kur duhej ta hiqte nga zverku, askush s'po e ndihmonte. Gratë u gajasën duke parë si kërcente pupthi me

njërën këmbë, sepse tjetra prapa qafës i kishte mbetur.

Floreta e takoi më vonë, ngaqë Marta Samrishit nuk po i ndaheshin lotët. Qante në atë mënyrë, më rrëfeu psikologjia, a thua se e shihte veten të vdekur dhe po e vajtonte në të gjallë. Dhe kishte ditë që herë pas here e zinte ankthi. Ajo ishte dënuar për plagosje me pasoja të rënda. Viktima kishte qenë i shoqi. Kur ai po e akuzonte për tradhti bashkëshortore, ajo e kishte gjuajtur me tiganin që mbante në dorë dhe bishti i kishte qorrur njërin sy. Avokati i kishte kërkuar gjykatësit që ta kualifikonte si plagosje pa dashje, rrjedhimisht aksidentale. Ai kërkoi gjithashtu provën e manekinit. Sikur njëqind herë të gjuhët manekini me tigan, zor që një herë bishti t'i nxjerrë syrin, etj. etj.

- Ankthi dhe stresi janë demonë binjakë, - tha Floreta, - ata ndihmojnë njëri-tjetrin.

Nga frika mos bënte vetëvrasje, donte ta ndihmonte Martën. Dhe më kërkoi bashkëpunim. Unë duhej ta kandisja Blinorin, pronarin e Shtëpisë, që të aplikonte si strehues. Vetë psikologjia do të përipiqej që Marta të përfshihej në listën e këtij strehuesi. Mirëpo u lodhëm më kot, sepse dy grupe do të përjashtoheshin nga projekti i strehimit. Femrat do të dërgoheshin në burgun e grave në kryeqytet, ndërsa adoleshentët në institutin e specializuar të Fierit.

Aq më tepër që, edhe pa e mësuar përjashtimin, ishte ende herët për ta ditur si do të bëhej aplikimi dhe si shpërndarja në shtëpitë e qytetarëve.

Ndërkaq, para se të tërhiqeshin formularët e aplikimit, pati lëvizje nga qytetarë të tjerë, të cilët qysh në krye kishin qenë kundër këtij vendimi. Me pankarta në duar, ata bllokuan zonën më të zakonshme, por edhe më tensionalen, rrugën me tabelat Të Ndershmit dhe Të Pandershmit. Mirëpo ishin të paktë në numër dhe, ndonëse aq afër, zëri i tyre nuk arrinte as deri në korpusin e të burgosurve. Ndoshta prandaj parapëlqenin më tepër rrjetet sociale, ku shfrenin pa u përmbajtur.

Mua më mbetet pak kohë për këto postime, por u hidhja ndonjë sy në internet. Sipas puritanëve radikalë, kjo zhburgosje masive do të çonte në një familjarizim masiv me kriminelët. Përfytyroni çfarë mund të ndodhë, shkruante dikush, sikur të hapen kafazet dhe nga kopshti zoologjik bishat të sulen drejt qytetit. A ka forcë t' u bëjë ballë instinkteve të tyre?! Ishte një status që po ngjallte diskutime, prej të cilave rridhte edhe ndonjë informacion. Sipas një komentuesi me prirje konspirative, shumë nga kundërshtarët ishin njerëz të nxitur nga vetë qeveria. Ajo ende shpresonte se, po të

ngjallej një vullnet ndryshe, procesi mund të ndalohej në çastet e fundit dhe gjithçka të mbetet në gjendjen e mëparshme. Ndërsa në një status tjetër njoftohej se nga korpusi ishin bërë transferime selektive, bazuar në vlerësimin e sjelljes dhe prognozës psikopatike të të dënuarve. Mendohej se në rrethanat e reja ata mund të shfaqnin anën e tyre më të errët, duke kryer veprime krejtësisht të papranueshme. (Jam dakord me Afërdita Strazimirin për errësirën e nënvetëdijes, i gjegjej një komentues. Por meqë vetë zonja i ka sytë e vegjël si të pulës, më mirë të merret me instinktët e shpendëve, sesa të bishës njeri.)

Sidoqoftë, unë e ndiqja kahjen e ngjarjeve, duke parë veprimet e institucioneve. Komisioni i Shpërndarjes Strehimore, që u ngrit me ngut nën kryesimin e prefektit, po u hapte rrugën punëve të radhës. Merrej me mend se cila ishte përgjegjësia kryesore e kësaj hallke. Qëkur nisën diskutimet e para në komision, Sazan Manzuranit iu desh të tërhiqte vëmendjen e anëtarëve për aspektin moral. Unë nuk jam nga ata burra që, për hir të një posti, shkel nderin tim. Jo, ky nuk është kuptimi im! Por aq më tepër nuk lejoj të sakrifkohet nderi i qytetit, deklaroi i nxehur.

Dhe kishte shkak. Dikush sapo kishte propozuar që, për të qenë sa më të qartë në masat e sigurisë, shpërndarja e të burgosurve të bëhej sipas tipologjisë së krimeve. Për shembull, në një lagje të krijohej një bllok me grabitësit e bankave, aeroporteve, vilave, shitoreve, makinave, distributorëve të karburanteve,

hajnat e xhepit dhe të kafshëve shtëpiake. Ky të mbante emrin konvencional Blloku i Dorës. Pastaj Blloku i Mashtruesve, Blloku i Falsifikatorëve, Blloku i Abuzuesve me Detyrën, Blloku i Dhunuesve, Blloku i Seksit, etj. Me bllonet e korrupsionit dhe atë të trafikimit të krijohej një lagje më vete.

Por të frymëzuar edhe nga prefekti, shumica u ngrit kundër. Njëri nga liderët e shoqërisë civile solli këtë argument: Po të ndiqnim këtë kriter, do të duhej fillimisht të bënim një renditje se cili do të ishte blloku i parë, cili i dyti e me radhë. Kjo do të thotë të bënim çfarë bëri poeti me rrathët e Ferrit. Por më thoni, ju lutem, cili prej nesh është Dante Aligeri?! Me sa e njoh unë modestinë e zotit Manzurani, as vetë prefekti nuk do ta merrte përsipër këtë atribut. Apo jo, zotëria juaj? Nuk do ta merrja, pohoi Sazan Manzurani, duke shtjelluar edhe një arsye më tepër. Shpërndarja diskriminuese do t'i jepte emër të keq mbarë qytetit, duke e kthyer në një Ferr të ri. Dhe kur? Kur komuniteti vendas, pikërisht prej aktit të vet human, pret që Burgasi të bëhet edhe më i lavdishëm. Duke pasur një mbrojtje të tillë, përfaqësuesit e të burgosurve as që patën nevojë të ndiheshin.

Ngërçi u zgjidh me një propozim për hartuesit e kontratës. Në tekstin e saj shihej e nevojshme të përfshihej edhe paragrafi, që u përpilua dhe u redaktua aty për aty: “Strehuesi nuk mund t'i zgjedhë të dënuarit. Por as Komisioni i Shpërndarjes nuk mund t'ia paracaktojë. Shpërndarja, sipas kërkesës



së çdo qytetari, do të bëhet me shortin e goglave të mbyllura. Ajo mbrëmje do të quhet Nata e Shortit dhe monitorues do të jenë palët e interesuara.”

Mbledhja po mbyllej, kur u shfaq Zihni Aviduli. Një pjesë të ekipit, me të cilin kishte ardhur, Ministri i Brendshëm e kishte stacionuar në Burgas, derisa të përfundonin kleçkat formale. Mirëpo ish-koloneli, ndoshta për vetë paraqitjen dhe tonin urdhërues, çka i kishte mbetur nga koha e ushtrisë, dukej sikur në Burgas s’po sillej si këshilltar, por si bajraktar.

- Hë mo, komisionarë, mbaruat me kazermimin? - pyeti duke hyrë.

Sesi tingëlloi fjala *kazermim*, sepse në komisionin e strehimit ishte hera e parë që dëgjohej.

- Zoti Aviduli, ne s’kemi ndër mend që në qytetin tonë të ngremë kazerma, - ia ktheu me takt prefekti, por edhe duke i dalë zot postit dhe detyrës së tij. E për t’u bërë më bindës, shtoi gjithashtu: - Bllloqet bllok krijojnë. Ky qytet bujar nuk meriton të bëhet me geto.

- Unë s’kisha parasysh qytetin, por Të Pandershmit, - s’u zmbrafs gjithsesi Aviduli.

Sazan Manzurani tundi kokën në çast, si t’i kishte dhënë dikush një goditje mbas shpatullave. Vetëm tani po kujtohej për dokumentacionin e komisionit. Ç’term kishin përdorur aty për të burgosurit? Gjithnjë të njëjtin apo edhe versione të tjera? Do t’i duhej të shihnte letrat. Megjithatë, për një mospërdorim ndihej i sigurt, mospërdorimin Të Pandershmit. Tekefundit, termi do të zgjidhet tjetërkund, mendoi, u takon ta

vendosin komisionarëve më të lartë, atyreve që po hartojnë kontratën. Ndërsa për ne korrigjimet do të jenë të lehta, shih e shkruaj.

Meqë mbledhja ishte mbyllur, zoti Aviduli e ftoi prefektin për kafe. Rrugës kërkoi ndjesë që ishte paraqitur me vonesë. Ai sapo kishte ngrënë një paçe me kokë viçi, gjithë lëng të yndyrshëm, gjithë inde e tru, siç po e përshkruante. Më dëgjo mua, miku im, nuk ka më të shëndetshëm se mëngjesi me lugë. Ushtarët tanë dikur e kishin këtë shans.

Zoti Manzurani hiqej sikur dëgjonte me respekt. Por duke mbajtur distancë nga supi i tjetrit, si të druhej se, sa herë që Aviduli fërgëllonte buzët e trasha, do ta stërpikte me salcë.

Ndërkaq, sapo kontrata mori formë funksionale, qytetarët filluan të tërhiqnin formularët dhe ta plotësonin përmbajtjen kutizë për kutizë. Ata dorëzoheshin në Zyrën e Pranimit, që kishte për detyrë vetëm këqyrjen formale, thjesht nëse aplikuesi i qe përgjigjur të gjithë pyetësorit. Më pas, Zyra e Pranimit ia kalonte Zyrës së Inspektimit. Megjithëse aplikuesi sillte mandat arkëtimin e bankës, hapi i parë atje bëhej. Duke dyshuar në vërtetësinë, inspektori i financës shkonte për të verifikuar në vend nëse aplikuesi e kishte derdhur shumën e garancisë në atë numër llogarie dhe dokumenti ishte lëshuar pikërisht nga ajo bankë.

Pastaj inspektorët e terrenit ia mësynin në banesën e qytetarit. Atje verifikoheshin të dhënat e formularit, sidomos hapësira për burgim. Në përpjesëtim me numrin e atyre që do të strehoheshin, çka qytetari e kishte shprehur tashmë, i plotësonte standardet kjo hapësirë? Po ose Jo, këtë mbanin shënim inspektorët. Nëse gjenin përputhje me të dhënat e nënshkuara nga kryefamiljari, thirreshin specialistët e angazhuar për planimetrinë e ndryshimeve të mjedisit, si dhe llogaritjen e preventivit. Te lista e ndryshimeve

gjithnjë do të përmendeshin: dera e parë me shufra çeliku, dera e dytë me sportel e lloz nga jashtë, dritarja me grilë metalike, banja e dushi me bolierë, tryeza e ngrënies, televizori, rafti i rrobave, etj.

Nga Zyra e Inspektimit dosja i kalonte Zyrës së Miratimit, ku nëpunës të tjerë rishqyrtonin rezultatet e teknikëve të terrenit, madje edhe hesapet e preventivit. Nëse nuk nënshkruanin arkitekti i burgjeve, specialisti i sigurisë dhe ai i financave, ardhur kastile nga kryeqyteti, dosja kthehej mbrapsht. Por nëse nuk bëheshin vërejtje, Zyra e Miratimit ia kalonte dosjen Zyrës Ekzekutive. Prej këtu niste veprimi. Afërmendsh, nënkontraktorët e saj kishin pranuar që materialet e ndërtimit t'ia shisnin me çmimet e shumicës. Por edhe kështu leverdia do të ishte e dyanshme.

Për të fituar kohë, punimet fillonin rast pas rasti, pa prituri që të shqyrtoheshin të gjitha dosjet. Kjo solli një gjallëri të menjëhershme në qytet, sepse u aktivizuan tri-katër firma të fjetura ndërtimi, të cilat rimorën forcën punëtore të skartuar. Por nxiti edhe nismën private të disa të tjerëve. Këta krijuan menjëherë brigada të vogla e të manovrueshme, duke u gjetur punë nomadëve të mëparshëm, atyre që prisnin çdo ditë ndonjë shans përpara Monumentit të Ushtarit të NATO-s.

Nuk po përmend gjallërimin e gazetarisë, pasi dihet, çdo ngurtësim i realitetit sjell monotoni për mediat. Unë çalltisja sa nëpër zyra, sa në takime personale, sa duke ndjekur ekipet në terren. Qytetarët që pyesja, nuk e mbanin të fshehtë për sa të dënuar

kishin aplikuar. Madje disa më tregonin edhe fotokopjen e formularit. Por vija re se, herë-herë, ata i shisnin edhe altruizëm njëri-tjetrit. Kush kishte kërkuar tre të burgosur, mbahej më mikpritës se kush do të strehonte dy. Ndërsa ai me katër ua kalonte për bujari të dyve.

Mua më tërhoqi vëmendjen Vlash Llazarani, fabrikanti i bimëve mjekësore, që kishte aplikuar për tetë persona. Kur e pyeta se, po të mos transferoheshin femrat, për cilën gjini do të aplikonte, ai e shoqëroi përgjigjen me një buzëqeshje reklamash, thua se fabrika e tij kishte të bënte me prodhim parfumesesh. For men, tha. Nga përvoja ime, shtoi pastaj, kam mësuar se femrat bëjnë mungesa në punë më shumë se meshkujt, çka do të thotë marrin më shpesh raport mjekësor.

Sa për mjedisin e strehimit, e pashë me sytë e mi. Pak më tepër se gjysma e fabrikës ishte e zënë, pjesa tjetër e ndërtesës ishte bosh. Që në projektimin e saj, zoti Llazarani kishte menduar perspektivën. Mirëpo pa kaluar ende dy vjet, pesëmbëdhjetë kilometra larg Burgasit u hap një fabrikë tjetër. Vlash Llazarani i shpëtoi falimentit, vetëm duke ngritur pagën për grumbulluesit dhe duke ulur çmimin e eksportit. Fabrika konkurruese u liçensua me allishverishe, sepse shkeleshin rregullat e tregut, u ankua ai, teksa më tregonte hapësirën që po përshtatej për burgim. Megjithatë, aty e përsëriti adresimin For Men. E mora me mend se kësaj here spicën po ma hidhte mua. Kur kisha shkruar për diferencën e lartë mes pagës së burrave dhe pagës së grave, FPBMA-ja (Fabrika

e Përpunimit të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike) kishte qenë një nga fshikullimet e mia.

Përderisa ende nuk e njihja përmbajtjen e plotë të Rregullores së Posaçme, i mbaja disi larg edhe glorifikuesit, edhe optimistët e parakohshëm. Për shumëkënd tashmë dukej e largët koha e protestës, së cilës po ia zinte vendin atmosfera e festës. Po cilës festë? Asaj të qelive me hekura shtëpi për shtëpi. A thua, vallë, do të mësoheshin qytetarët e Burgasit të bënin edhe rolin e gardianit?! A nuk do të kishte një zhbürgosje masive dhe një burgim masiv njëkohësisht?!

Duke ia lënë festën medias lokale (Gloria TV ngulte kamerat nëpër banesa dhe transmetonte drejtpërdrejt edhe shkëndijat e saldatriçeve), në raportimet e mia e ndaja lajmin nga komentet. Në shkrimet editoriale, zakonisht, ngulmoja te respektimi i Të Drejtave. Ishte e çuditshme si e gjykonin këtë ngulmim lexues të njohur e të panjohur. Opinione nga jashtë më vinin lehtësisht, por nuk mungonin as nga banorët e korpusit, siç kisha nisur t'i quaja kohët e fundit. Mbaj mend një numër telefonik me 20. Jo vetëm për mesazhet e shpeshta, por edhe për spikatjen ndaj Të Drejtave. Me gjasë, dikush më kurajonte vazhdimisht dhe, në fund të tekstit, do të shtonte gjithnjë: “Keni përshëndetje nga zoti Karabolli.” Madje edhe: “Mirënjohje nga zoti Karabolli.”

Ky zotëria i mirënjohjes mos ishte vetë i dënuari Emanuel Karabolli, që ia kishte dalë të mbante fshehurazi telefon edhe në burg? Burimet nga brenda më informuan se ishte njëri nga mbështetësit e tij në kryeqytet.